


Akoma nuk keni një WEBSITE ?



Si mund të jetë
e besueshme një
kompani që nuk ka
website?
073 4066 5946



30 Avenons Road,
London, E13 8HT
Tel 020 7018 7929

www.dotech.uk

The Albanian

VITI I 17 I BOTIMIT 25 SHKURT 2021

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

BRITANIA NORMALITET NË QERSHOR KUFIZIMET LIGJORE HIQEN NË 21 QERSHOR, UDHËTIMET NDËRKOMBËTARE FILLOJNË PAS 15 MAJIT



PETRIT KUÇANA
**TË TALLESH
ME DIASPORËN...**



ARBEN MANAJ
Anglia pritet të rivendikoj liritë
e saj të privuara nga pandemia
më 21 qershor. (faqe 5)

**DEMONSTRATAT E
ZÜRICH-UT DHE
DASHNORI I MESNATËS**
DAUT DAUTI



**IZOLIMI I KOSOVËS,
SAGA E VIZAVE DHE
BLOKADA FRANCEZE**
ENVER ROBELLI



**20 SHKURTI SI DITË
HARRESE
KOLEKTIVE**
JONILA GODOLE



**MALLËNGJIM
KRYEMINISTROR**
EDMOND TUPJA



**PËRTEJ "SHKUNDJES
SË PERËNDIMIT"**
DITMIR BUSHATI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



The Albanian newspaper in London

www.thealbanian.co.uk

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Kaq të kokalvitura duken këto shifrat e shqiptarëve të diasporës, saqë i kalojnë caqet e të neveritshmes. Në çdo përsëritje të tyre, tani që duhet t'i vënë kapak asaj punës së votës së diasporës, gjithkujt i kujtohen premtimet e fillimit. Edhe ajo pjesë e diasporës që nuk i ka ndjekur zhvillimet në Shqipëri, me patjetër u kujtohen Samitet e Diasporës. Mbase u kujtohen

tam-tamet në simfoni të plotë me propagandën, se kjo qeveri do të realizojë premtimin e saj për diaporën e madje do të bëjë shumë më shumë se kaq. Nuk ka si të mos kujtohen këto, kur KQZ-ja deklaroi se numri i shqiptarëve të diasporës të regjistruar është më pak se 1000, pra as ata që ishin në njërin samit të ashtuquajtur të Diasporës. Imagjino se janë bërë dy samite të Diasporës, dhe sot, as socialisti më i flaktë nuk di të thotë se çfarë ishin ato samite, e aq më pak çfarë konkretisht përfitoi diaspora prej tyre.

E nëse shumëkush e shikon Majkon si përgjegjës, mbase duhet shikuar ndryshe; në mos si e keqja më e vogël, një e keqe e konsiderueshme, jo thjesht se ai është ministër po aq sa Spiropali, pra ministër shteti, por se nuk mundi të jetë as i tillë, pasi ai

është ministër i Diasporës dhe ka një peshë specifike së paku më të madhe se Spiropali.

Majko mbetet ministri që nuk mundi. Nuk mundi të jetë ai ministri i Diasporës, nuk mundi të jetë ministri për bashkues, që të mbronte interesat e diasporës, të paktën të regjistronte diasporën. Mbase shumëkujt u kujtohen shqiptarët e mbetur në mes të acarit në Kapshticë, ku nuk u lejohej hyrja në ardhe. Majko nuk u dëgjua, por u tha se kishte bërë operacion gojën... Sikur të mos mjaftonte kjo Majko nuk gjeti kurajon prej qytetari që t'u kërkonte ndjesë atyre shqiptarëve, por çështja u kalua ashtu heshturazi dhe siç ndodh në mëmëdhe lajmi zgjat tre ditë, por mbase tek shqiptarët e diasporës është më ndryshe... Shumë gjëra nuk mund të harrohen. Diaspora është shumë më shumë se

një shifër, shumë më shumë se një fjalim patriotik që tretet brenda orësh në këllirën politike, ku opozita gjendet fajtoje me një të rënë të lapsit.

Thua janë mbi 1000 shqiptarë që kanë bërë foto me Majkon? Të paktën ata të ishin regjistruar...

Çfarë e ka penguar shtetin shqiptar të regjistrojë diasporën? Duket fyese për çdo shqiptar të diasporës kur kujton se edhe Sajmit Tahiri ish-ministër i Brendshëm ka premtuar regjistrimin e diasporës, pa përmendur ish-ministrin e jashtëm Bushati.

Kush e pengoi këtë regjistrim, si proces administrativ dhe jo politik?

Mbase Majko dhe ministria e tij nëse i bëjnë përlllogaritjet rreth 1000 vetave u kanë dhënë tituj dhe dekorata.

A ju kujtohen ambasadorët e kombit? Të paktën ata a janë të regjistruar?

Apo kjo nuk është e rëndësishme, nuk

i shërben kurrësesi propagandës. U kry puna me ta; u përdorën dhe kaq. Majko dhe kolegët e tij duken se e menduan hollë për të gjetur një strategji tjetër propaganduese, duke i lanë topin në derë të KQZ-së. U caktua KQZ-ja që të përballonte këtë mos-veprim, dhe thjesht të rikthehet jo thjesht në objekt sulmi, por edhe në arsye se pse nuk u bë kjo punë. Nëse parlamenti do t'i votonte aktet nënligjore dhe ta vendoste KQZ-në përpara aktit të kryer, kë do të fajësonin? Nuk ka asgjë të keqe që Majko të strehohet pas Erjon Velisë se asaj partie i përket, dhe duket që vetëm aty e ka shpëtimin, por si Ministër i Diasporës Majko thjesht nuk mundi as të jetë ministër dhe as të jetë ai Majko i perceptuar. U zhvesh nga çdo kostum tej-partiak dhe mbeti në të vetmen pallto që mund ta mbarnte. Të paktën ai mund të bënte një gjë të fundit, të kursente diasporën nga tallja, përçmimi...

Shepherd Harris & Co Solicitors

Nickel House, 96 Silver Street, Enfield, EN1 3EL



Property Matters

- Buying your property
- Selling your Property
- Re-Mortgages
- Lease Extensions & Queries
- Property Development

Contact Florinda Pjetri
Email: FPjetri@Shepherd-Harris.co.uk

Criminal Matters

We deal with all areas of crime including: -

- Money Laundering (proceeds of Crime & Forfeiture)
- Drugs (Possession, Cultivation, Importation & Supply)
- Assault (GBH, ABH & Murder)
- Road traffic Offences



We offer Legal Aid and Fixed Fee Arrangements.

Contact: Gennaro Baffa
Email: GBaffa@Shepherd-Harris.co.uk
24 hour emergency crime line – 07803 615602



Personal Injury

If you have been involved in an accident (for example in a road collision or at court) we can assist you in receiving

compensation.

We offer "No Win, No Fee" Arrangements

For a free consultation contact Gennaro Baffa

Email: GBaffa@Shepherd-Harris.co.uk

Family Law

We deal with all areas of family law including: -

- Divorce
- Financial relief
- Children act matters
- Injunctions / Domestic Violence
- Child Abduction

Email: Mail@Shepherd-Harris.co.uk



Për konsultime falas ju lutemi të kontaktoni Florinda Pjetrin

020-8363-8341 WWW.LAW4U.CO.UK

Konsultimet Falas

Ne jemi nje zyre avokatie e specializuar vecanerisht ne fushen ligjore te emigracionit. Ne kemi nje perzgjedhje unike avokatesh dhe baristeresh te cilet jane specializuar dhe kane ushtruar profesionin qe ne 1999. Qellimi yne eshte te ofrojme kualitetin me te larte te klienti, per çmimin me te arsyeshem



SHERBIMET QE OFROJME NE ÇESHTJET E EMIGRACIONIT PERFSHIJNE

Human Rights
Judicial Review
Appeals

(we have in house barristers)

Fresh claims
Asylum

Overstayers
Stateless
Detention & Bail
EEA family permit
EEA Permanent Residence
Indefinite Leave to Remain (ILR)

Nationality
Spouse Visa
Visitor Visa
Dependent children
Student,
Work & Entrepreneur Visa

Jemi te specializuar ne aplikimet per nderrimin e shtetesise nga Kosovar ne Shqiptar

-In house Barristers with over 20 years of experience who handle the cases with maximum professionalism through all stages including representation to the Supreme Court

-Fully accredited by the Bar Standard Board

-Licensed by the Bar Council under its Bar Direct/Public Access scheme


-Member of the Honourable Society Lincoln's Inn



Per me shume informacion dhe per konsulten falas kontaktoni Adelen

Mob:

07901181592



NEW DAY DELIVERY



DIRECTOR

Flori Papushi
0794 600 2706

Branches

EDMONTON N18 1HY

Tel: 020 3198 6358

LEA BRIDGE E10 7PN

Tel: 020 8539 6352

WALTHAMSTOW E17 3HT

Tel: 020 8520 2600

ILFORD IG1 1QP

WOOLWICH SE18 5QZ

WWW.ROMAN-TILES.COM

Instagram- ROMAN.TILES

**50%
off**

DERI NE 50%

ZBRITJE

PER TE GJITHA

BIZNESET SHQIPTARE



ALL LARGE FORMAT TILES IN STOCK

ALL SIZES AVAILBLE

240X120,160X80, 120X120, 80X80

120X60,120X20, 60X60, 30X60



ARBEN MANAJ

Anglia pritet të rivendikoj liritë e saj të privuara nga pandemia më 21 qershor.

Ky është objektivi i një plani prej katër fazash që shefi i ekzekutivit britanik Boris Johnson njoftoi në parlament. Sipas tij, shkollat do rihapen më 8 mars ku disa aktivitete jashtë shkollore do rifillojnë më 20 mars, e ku më pas më 12 prill do jetë hapi tjetër për hapjen e dyqaneve joesenciale e salloneve të bukurisë, palestrave, librariave, muzeumeve dhe kopshteve zoologjike.

Ndërkohë pubet, restorantet, kinematë, hotelet pritet të hapen më 17 maj së bashku me tifolet nëpër sta-

KUFIZIMET LIGJORE HIQEN NË 21 QERSHOR, UDHËTIMET NDËRKOMBËTARE FILLOJNË PAS 15 MAJIT



dium e koncerte. Pushimet jashtë shtetit dhe udhëtimet ndërkombëtare nuk do i kthehet normalitetit përpara mesit të muajit maj.

Dhe më 21 qershor të gjithë kufizimet ligjore për kontaktet sociale do hiqen, ku do hapen edhe pjesë të tjera të ekonomisë britanike.

Sipas Boris Johnson rruga drejt daljes do jetë e kujdesshme, por e pakthyeshme. Shpresohet se këto masa do mbesin të pandryshuara, nëse do

vazhdojë si deri më tani me këto ritme, vaksinimi i popullsisë, nuk do ketë shtim të infektiveve dhe shtrimeve në spitale si dhe nuk do ketë ndonjë dalje të ndonjë variacioni apo shtamë më të rëndë të koronavirusit.

Britania ka kaluar dy valë pandemie dhe tre lockdown deri më tani dhe shpresa është se ky do të jetë i treti dhe i fundit, kur e tërë popullsia e rritur e Britanisë do jetë imunizuar deri në fund të korrikut. tch

AMBASADORI BRITANIK PËRSËRIT APELIN PËR PARTITË POLITIKE: SIGURONI KANDIDATË TË PASTËR!

Ambasadori britanik, Duncan Norman, ka përsëritur apelin për krerët e partive politike në vend, që "të sigurojnë kandidatë të pastër" në listat për deputetë.

Me një shënim në Twitter, Norman shkruan se kandidatë duhet të jenë persona që duan të përfaqësojnë qytetarët dhe të mos jenë të përfshirë me krimin e organizuar ose korrupsionin, apo të lidhur drejtpërdrejt me ata që janë. "Afati për të dorëzuar listat e kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e 25 Prillit është shumë pranë. Partitë politike duhet të sigurojnë që kandidatët që duan të përfaqësojnë qytetarët të mos



jenë të përfshirë me krimin e organizuar ose korrupsionin apo të lidhur drejtpërdrejt me ata që janë", shkruan ambasadori. Të njëjtën thirrje të përsëritur ka bërë edhe ambasadorja e SHBA, Yuri Kim, duke theksuar se shqiptarët "nuk duhet të votojnë për kriminelë".

HA

HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMAT FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

PARLAMENTI EVROPIAN: PAVARËSIA E KOSOVËS ËSHTË E PAKTHYESHME

Me 50 vota për, dhjetë kundër dhe nëntë abstenime, Komisioni për politikë të jashtme i Parlamentit Evropian ka miratuar raportin për Kosovën të përgatitur nga Viola Von Cramon-Taubadel, deputete e të Gjellbërve nga Gjermania.

Me këtë raport, Parlamenti Evropian u bën thirrje edhe një herë pesë shteteve të Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë. Spanja, Sllovakia, Rumania, Qiproja dhe Greqia janë pesë vende anëtare të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në një komunikatë të lëshuar nga PE-ja pas këtij votimi, thuhet se “deputetët nënvizojnë se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme dhe njohja nga të gjitha shtetet e BE-së do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë”. Deputetët evropianë po ashtu kanë përsëritur edhe thirrjen për liberalizimin e vizave për Kosovën, pasi Komisioni Evropian qëmoti ka konstatuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara.

Para se të votohej për raportin si tërësi, ishte votuar për amendamentet e veçanta të prezantuar nga deputetët e Parlamentit Evropian.

Raportuesja për Kosovën, Viola Von Cramon, e cila edhe e kishte përpiluar tekstin e raportit, është shprehur e kënaqur me miratimin e këtij raporti. “Ky rezultat tregon se shumica në Parlamentin Evropian e mbështesin



Kosovën në rrugën evropiane. Ne qartë shohim potencialin e këtij vendi, por edhe të Bashkimit Evropian. Por, ende ka punë përpara për Kosovën. Së pari na duhet një stabilitet politikë për zbatimin e reformave të nevojshme”, ka thënë Von Cramon teksa ka komentuar votimin për raportin për

Kosovën.

Ajo ka thënë se edhe BE-ja ka “detyra të shtëpisë” për të bërë. “Prandaj kemi bërë thirrje për Këshillin (e BE-së) që më në fund të miratojë vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës”, ka thënë Von Cramon.

Në raport, Kosova kritikohet për mungesë të progresit të duhur në shumë fusha, sidomos në zbatimin e prioritetëve të agjendës së reformave evropiane.

Deputetët shprehën keqardhje për vazhdimin e jostabilitetit politik dhe u kanë bërë thirrje të gjitha forcave politike në Kosovë që të angazhohen për reformën e sistemit politik, në mënyrë që të përmirësohet qartësia ligjore dhe procesi i formimit të qeverisë.

Po ashtu, kërkohet që Kosova të sigurojë reformën e sistemit gjyqësor në mënyrë që ai të jetë më transparent, efikas dhe pa ndërhyrje politike. Në të njëjtën mënyrë, kërkohet edhe reforma e administratës publike.

Në raport përmendet se Kosova ka një “mjedis pluralist dhe të gjallë mediatiq”, por kërkohet që të garantohet transparencë e plotë e pronësisë së mediave dhe pavarësia dhe liria nga ndikimet politike.

Anëtarët e Parlamentit Evropian kanë përsëritur thirrjet që raportet e Kosovës me Serbinë të mbetet prioritet dhe kusht për avancimin e të dyja vendeve në procesin e integrimi evropiane.

Ata kanë kërkuar nga qeveritë e të dyja shteteve që të përmbahen nga çfarëdo veprime që mund të pengojnë krijimin e besimit mes palëve, që do ta vinin në rrezik vazhdimin konstruktiv të dialogut. Nga Kosova është kërkuar që të përballlet edhe me problemet e brendshme në qasjen e saj ndaj dialogut me Serbinë, që ndërmjetësohet nga BE-ja.

Të njëjtën ditë në Komisionin e politikës së jashtme është miratuar edhe Raporti për Serbinë. Edhe Serbisë i është dërguar porosia që të jetë konstruktive në dialog me Kosovën. Deputetët kanë kritikuar fushatën kundër BE-së në Serbi, përfshirë edhe në mediat e financuara nga shteti. Ata kanë kërkuar që udhëheqësit politikë në Serbi të shprehen qartë dhe pa hezitim për orientimin pro-evropian të Serbisë. Po ashtu, eurodeputetët kanë kërkuar nga Serbia që t'i bashkohet qëndrimeve të BE-së në çështjet e politikës së jashtme.

Raportet për Serbinë dhe Kosovën, të miratuara në Komisionin e politikës së jashtme, do të barten në formën e propozimeve për rezolutë në seancë plenare të Parlamentit Evropian.

REL

ARBAN DOMI

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit, debateve thellesisht preokupuese për publikun lidhur me vaksinimin dhe depolitizimin e pandemie, vulnerabilitetin ekonomik, cilesine e shërbimit shëndetësor dhe eficiencën e sistemit gjyqësor, u shtohet dhe ai i votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. I gjendur në veshitësi jo të pakta për të kujtuar një precedent të vetëm në keto tre dekadat e fundit ku debati çilesor e i argumentuar të këtë paraprire një vendimarrje inteligjente dhe të vlerësuar pozitivisht në sferën e opinionit publik, dëshiroj megjithatë të ndaj modestisht disa ide, i motivuar nga dëshira për të kontribuar realisht në dobi të një zgjidhjeje të mire për të ardhmen e vendit. E anatemuar nga disa, e drejta kushtetuese e votes së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve mund dhe duhet të konsiderohet një projekt i rëndësishëm në favor të zhvillimit ekonomik, social e politik të vendit.

Një nga argumentet kundër votes së shtetasve që jetojnë jashtë vendit është ai i votimit të emigrantëve në favor të partive dhe/apo politikave të cilat nuk influencojnë drejtperdrejt jetën e tyre por atë të bashkatdhetarëve që jetojnë brenda kufirit. E gjej të tepert dhe tejet të hidhur të kujtoj këtu që në tri dhjetë vjetet e fundit, kryesisht fale votave të shqiptarëve

benda kufirit dhe konceptit të saj libertin mbi respektimin e votes, klasa politike shqiptare këmben me sukses tepsi, kazane, sahanë, magje, kusi apo sini, çka në vendlindje përben një sinonim të pushtetit politik dhe pertej. Një argument tjetër që kundërshton votën e emigrantëve lidhet me mospagimin e taksave nga ana e tyre në Shqipëri çka përjashton njekohësisht, me një të rënë të lapsit, edhe shume shqiptarë brenda kufirit që perballen për fat të keq me papunësi të padëshiruar.

Një qasje alternative që fokusohet në interesa apartiake e trajton votën e emigrantëve në kontekstin e një ndryshimi të thelle ligjor me impakt ekonomik e politik që gërsheton të drejtën për të votuar me detyrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve për të kontribuar financiarisht në të ardhurat e shtetit shqiptar nepermjet taksimit të të ardhurave si dhe mundësine e perfaqesimit në parlament. Për të ilustruar këtë ide po përdorim një prag reference 3% duke kujtuar që 3% e të ardhurave vjetore të një emigranti, sado modeste qofte pagesa e tij, përben një shifer në vlerë absolute në shume raste me të larte se taksa mbi të ardhurat e shume shtetasve që jetojnë brenda kufijve.

E gjej me vend të sjell në vemendje të gjithë bashkekombesve që jetojnë

SI MUND TË ARRIHET VOTA DHE ZGJEDHJA E EMIGRANTËVE



jashtë vendit që ushtrimi i të drejtave si shtetas shqiptarë është i dobishëm të konsiderohet në prizmin edhe të detyrimeve të secilit prej nesh për vendin ku lindem e u rritem dhe kemi ende familjare, miq e të aferm. Nese në fillimet e rugetimit tone për një jete me të mire mundësite ekonomike të secilit ishin të kushtezuara nga perpjekjet jo të vogla për sigurimin e nevojave baze të familjeve tona, sot tabloja është çilesisht e ndryshme. Për me teper, në ngjashmeri me shume vende të tjera, Shqipëria mund të angazhohet, në marreveshje me vende ku emigrantet shqiptarë jetojnë, për deduktimin e kesaj shume financiare nga detyrimet taksore vjetore të çdo individit në vendin ku jeton. Me të ardhurat e gjeneruara nga taksa e emigrantëve mund të krijohet një fond zhvillimi strategjik i cili mund të

bente të mundur planifikimin dhe implementimin e projekteve me rëndesi kombetare në infrastrukture, arsim, shëndetësi, apo furnizimin me uje dhe energji elektrike të te gjithë territorit të vendit. Ky fond do mundësonte objekte të kushtueshme me rëndesi afatgjate apo mund të ulte ndjeshëm nevojën e borxheve në banka dhe institucione financiare nderkombetare me perqindje jo të vogla huamarrje.

Në aspektin politik, duke konsideruar se rreth 30% e shqiptarëve me të drejte votimi jetojnë jashtë Shqipërisë, e gjykoj të arsyeshme që ata të kene një perfaqesim prej 10% në parlament. Perfaqesimi parlamentar, për shkak të edukimit formal dhe ekspertizave profesionale në vendet demokratike perendimore ku emigrantet punojne, do përmirësonte cile-

sisht nivelin e vendimarrjes nepermjet eliminimit të konfliktualitetit dhe vulgaritetit që karakterizon mardheniet ndermjet palëve politike, defaktorizimit të aleancave regressive ndermjet partive të medha dhe atyre të blloqeve dhe fletoreve, dhe inkurajimit të kompromisit në emer të interesave madhore dhe progresit të vendit. Dëshira e mire për zhvillim real dhe të shpejte është e nevojshme dhe krejt e mundur të materializohet nepermjet kontributeve të secilit, pavaresisht vendodhjes gjeografike.

Personalisht, këtë alternative e gjej teper më të shëndetshme krahasuar me hostilitetin absurd ndermjet shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve dhe atyre që jetojnë jashtë, atdheadashurine dhe nacionalizmin badjava të rrjeteve sociale, apo perparimin e vendit me ritmet e breshkes, të amplifikuar nga kuratore uber të talentuar të propagandes nga njera ane dhe të kontestuar simetrikisht nga tellallë të ngjirur nga ana tjetër. Gjithsesi, klasa politike është e mirepritur të na provoje gabim duke konsideruar meriten e ideve të mesiperme dhe duke u investuar seriozisht në një projekt demokratik gjithepershires, në emer të progresit të vendit, i cili nuk mund të kryhet pa njohjen, vleresimin dhe shfrytëzimin real të kapaciteteve ekzistues humane dhe financiare, brenda dhe jashtë tij.

Shpresa Programme organizoi një nga eventit më të preferuara për familjen tonë të madhe dhe të larmishme: PAVARËSINË E KOSOVËS

Eventi u organizua në orët e pasdites të së Premtes së 19 Shkurtit në platformën virtuale në ZOOM. Pavarësisht se cdo gjë ishte akomoduar dhe azhornuar virtualisht nuk mungoi emocionet dhe pregatitjet e të gjithë stafit dhe familjes së Shpresa Programme për të mirëpritur të ftuarit e vecantë të këtij eventit si dhe pjesëmarrësit në ZOOM dhe në mediat tona sociale ku eventit u transmetua drejtpërdrejt.


Eventi filloi me mikpritjen e ngrohtë të stafit të Shpresa Programme nga Hermonda dhe Alketa dhe pjesëmarrësit u ftuan të ndiqnin një videomontazh mbi historinë kronologjike të Kosovës ndër vite. Pasuese ishin tingujt e bukur të pianistes së nderuar Mariela Cingo kur ajo prezantoi në Piano për ne Himnin Kombëtar të Kosovës dhe Himnin Kombëtar të Shqipërisë. Ndjekur nga duartrokitjet të ngrohta, Luljeta Nuzi, Drejtoreshë Egzekutive e Shpresa Programme e cila foli për rëndësinë e këtij eventit për komunitetin Shqip-folës, punën e palodhur të Shpresa Programme dhe fushatat me të cilat familja e madhe e Shpresa Programme trajton probleme dhe çështje të rëndësishme për komunitetin tonë si Gjuha Shqipe si GCSE, Shëndeti Mendor, Mjedisi, e drejta e punës dhe shumë të tjera.

Këto fjalë të bukura i ndoqën të ftuarit tonë special. Adelina foti të nderuarin Osman Caka i cili i përloti të gjithë me përjetimet e tij personale gjatë luftës së Kosovës. Bekim Halimi gjithashtu ndau me ne përjetimet e tij personale gjatë shërbimit të tij në ushtrinë e Kosovës, na emocionoi dhe na mbushi me patriotizëm. Fituese e cmimit 'Gruaja Imigrante e Vitit', kandiduese dhe fituese e cmimeve të tjera të nderuara, dëgjuam Remize Zeka Sherifin e cila ishte një frymëzim për të gjithë ne. Së fundmi, por pa diskutim, jo nga rëndësia Baca Bedri Islami djali i Zenel Islamit i cili është bazimi i shkriarit të famshëm Migjeni për personazhin e tij të mirënjohur Luli i Vocërr, Baca Bedri ndau eksperiencat e tij me ne si pjesë-dar i lidhshimit të UCK-së, vlerësimin dhe dashamirësinë ndaj Kosovës.

Tingujt e Mariela Cingos finalizuan emocionet e grumbulluara nga të ftuarit dhe fjalët e tyre, por nuk mbaroi me kaq. Talenti i ri, Alketa Ratkoceri shoqëroi emocionet tona të vazhdueshme me zërin e saj të bukur dhe na mbushi zemrat me patriotizëm. Esmeralda Barhani pasoi me 'Building Bridges' ku ajo foli për familjen e saj të madhe dhe të bukur në bashkëbisedim me Alketën.

Po i afroshim fundit të programit, megjithatë të ftuarit dhe pjesëmarrësit

SHPRESA NË PAVARËSINË E KOSOVËS



qëndruan të vëmendshëm. Fëmijët e mrekullueshëm të projektit Keep It Wild prezantuan 3 pika historike dhe natyrore të Kosovës dhe folën për vlerat e tyre arkitekturore, arkitektonike, gjeografike, kulturore dhe sociale të tyre. Ato gjithashtu folën për vlerën e konservimit të këtyre monumenteve.

Falenderojmë fëmijët: Anise, Dejzi, Erik, Emily, Glen, Jessica, dhe Lisa

Në fund Migena Adamou dhe Hermonda Kalludra prezantuan fushatën e re të Censusit për të cilën mund të lexoni më shumë më poshtë.

"Për të përmbyllur këtë event të mrekullueshëm dhe emocionet që akoma qëndrojnë prezente me ne ju lë me fjalët e Luljeta Nuzi, Drejtoreshë Egzekutive të Shpresa Programme. 'Nga thellësia e zemrës time, ju uroj, Gëzuar Pavarësinë e Kosovës. Mos e harroshim kurrë historinë e këtij vendi. Pacim forcën për të krijuar jetë pozitive intelektuale dhe kolektive dhe të ndihmojmë ato rreth nesh. Le të përmbushim obligimet tona si qytetarë të këtij shteti por edhe të jemi ambasadorë të vendit tonë. Vitin e kaluar festuam këtë event në qendër të qytetit, në Muzeun e Londrës ku për herë të arë kishte rrëfime dhe testimoni. Këtë vit, Adelina Badivuku dhe skuadra mbështetëse kan organizuar dicka të ngjashme, pasi ne nuk duhet të harrojmë dhe brezi i ri duhet të mësojë. Faleminderit që ndodhni sot në ZOOM dhe ju ftoj të shijoni eventin.

Gëzuar Pavarësinë e Kosovës."

Censusi 2021

Ji gati për Censusin! Të gjitha familjet në Angli dhe Wales do t'u kërkohet së shpejti të marrin pjesë në Censusin 2021. Censusi bëhet njëherë -në-dekadë dhe jep vlerësimin me të sakte të numrit të popullsisë në Angli dhe Wells. Kjo ka ndodhur rregullisht që nga viti 1801, me përjashtim të vitit 1941. Ket vit do të behet regjistrimi i parë digjital, ku familjaret do të marrin një letër që përmban një kod hyrës unik, që i lejon të plotësojnë pyetësorin në kompjuterin e tyre, në telefon ose në tabletë. Forma në formatin e letrës dhe ndihma me përkthimin në gjuhën amtare është e disponueshme sipas kërkesës. "Një regjistrim i suksesshëm do të mundësojë që nga qeverisja lokale deri të shoqatat të ofrojnë punë dhe fonde në vendet ku janë më të nevojshme, si shërbimet mjekësore, shkollat dhe rrugët e reja të transportit. Ja përse është shumë e rëndësishme pjesëmarrja dhe ja përse e kemi bërë me të lehtë për njerezit ta bëjnë regjistrimin online në çfarëdo lloj mjeti elektronik, duke ofruar dhe ndihmë". Ian Bell, ekspert kombëtar i mbajtjes së statistikave pranë Zyrës së Statistikave Kombëtare. Dita e Regjistrimi do të jetë 21 Mars 2021, dhe familjet në të gjithë vendin do të marrin letra me kodin hyrës online që i lejon të bëjnë regjistrimin. Censusi i do të përf-

Shpresa Programme

Inspiring hope & change

shijë pyetje që kanë lidhje me moshën, gjininë, punën, shëndetin, edukimin, anëtarët e familjes dhe përkatesinë etnike. Dhe, për herë të parë, do të ketë dhe një pyetje në lidhje me pjesëmarrjen apo jo në forcat ushtarake. Për ata që janë mbi 16 vjeç, ka disa pyetje jo të detyrueshme mbi marrëdhëniet seksuale dhe identitetin gjinor. Mbani mend, nga plotësimi i censusit, ju po ndihmoni të siguroheni që ju dhe komuniteti juaj merr shërbimet e nevojshme për 10 vitet e ardhshme dhe më shumë se atë. Kushdo që ka nevojë për ndihmë në plotësimin e pyetësorit të Censusit, mund ta bëjë duke telefonuar 0800 141 2021. Përveç kësaj ka edhe një linjë që ofron mbështetje në përkthimin e gjuhës amtare 0800 587 2021 Të dhënat personale të mbledhura do të mbeten private për një periudhë prej 100 vitesh, të sigurta për brezat e ardhshme. Për më shumë informacion, vizitoni faqen census.gov.uk.



DAUT DAUTI

Në verën e vitit 1980 Zürich-u ka qenë sikur në gjendje lufte. Demonstratat e grupeve të rinjëve kanë qenë të përditshme por gjatë fundjavës bëheshin masive dhe qyteti bllokohej. Demonstruesit i thenin xhamat e lokaleve dhe ua vënin flakën dyqaneve të shtrenjta. Përleshjet e demonstruesve me policinë i karakterizojnë një dhunë e çuditshme. Policia akuzohej për përdorim të tepëruar të dhunës por as demonstruesit nuk e lënin keq. Ata përdornin tulla, gurë e copa të metalit për t'i gjuajtur policët.

Pasi që nuk e dija gjermanishten, nuk e kuptoja cili ishte qëllimi i këtyre demonstratave. I pyesja shqiptarët që i takoja, por as ata nuk e dinin edhe pse kishin kaluar vite në atë qytet. Të gjithë përgjigjeshin gati njësoj: 'Drogirashë be, qijav nanën'.

DEMONSTRATAT E ZÜRICH-UT DHE DASHNORI I MESNATËS

Një ditë në stacionin e trenave e mora 'The New York Times' pasi që e pashë se në faqen e parë ishte një fotografi e demonstratave në Zürich. Me fjalë tjera këto demonstrata kanë qenë lajme të rëndësishme në shtypin e botës.

Arsyeja që i shtynte të rinjtë të demonstroi ishte mungesa e interesimit të shtetit për zhvillim kulturor të rinisë. Kërkesa e një organizate për fonde që do ta mundësonte hapjen e një qendre rinore, refuzohej vazhdimisht. Ishte refuzuar edhe kërkesa që t'iu jepej një ndërtesë e një fabrike të braktisur, e cila do të adaptohej në qendër rinore. Pas këtij refuzimi, në maj 1980, pas koncertit të Bob Marley-it, pothuaj të gjithë pjesëmarrësit e kishin sulmuar ndërtesën e Operës së qytetit e cila po merrte fonde të majme dhe së cilës i ishte dhënë fabrika e braktisur për vendosjen e rekuizitave.

Pra, shteti po e ndihmonte kulturën klasike dhe po i injoronte nevojat e rinisë. Kështu kishte filluar problemi, i cili gjatë atyre viteve te rinia e Zürich-ut, sikur edhe gjetiu në botë, po ndikohej nga 'Rock'-u dhe sidomos 'Pank'-u që po bëhej infuzion i rebelimit.

'Langstrasse' përfundonte në 'Limat

Platz', në bregun e lumit Limat, i cili ujin e sillte nga liqeni. Përkaj bregut të lumit, ku sot gjendet stacioni i autobusave, ka qenë një ndërtesë e braktisur të cilën e kishin okupuar të rinjtë, në mesin e tyre edhe disa narkomanë.

Ndërtesa ka qenë e gjatë, dy katëshe me mure të rënduara me grafiti. Ishte në proces të rrënimin për t'i bërë vend një ndërtimi të ri. Por, në këto momente këta të rinj e kishin okupuar për vete dhe kompania ndërtuese ishte larguar. Aty flinin disa qindra prej tyre. Në mëngjes zgjoheshin dhe mblidheshin në oborr.

Aty vinin edhe disa qindra tjerë prej diku tjetër dhe kur bëheshin bashkë, me parulla në dorë, e sulmonin ndërtesën e muzeut kombëtar (Swiss National Museum) të cilë dëshironin ta kthenin në qendër rinore.

Ndërtesa gjendej afër dhe përballë stacionit të trenit, Zürich Hauptbahnhof.

Para kësaj ndërtese, e cila atëherë ka qenë e bukur sikur që është edhe sot, qëndronte kordoni i policisë dhe beteja fillonte.

Kjo përleshje ka qenë e përditshme dhe ka zgjatur disa vite.

Në mbremje, kur përfundonte beteja, demonstruesit ktheheshin në ndërtesën e tyre. Për shkak që ndërtesa nuk kishte dritare e as dyer,

nga rruga shiheshin dyshekët e shtruar ku demonstruesit shtriheshin për të fjetur kolektivisht. Dominonte një kolorit interesant nga batanijet e ndryshme. Shumë prej tyre rrinin zgjuar natën dhe në oborr ndiznin zjarre e rreth tyre hanin, pinin e këndonin. Kjo ndodhte në qytetin më të pasur të Zvicrës. Pamje e rëndë që ta përkujtonte situatën e pasluftës së ndonjë shteti të botës së tretë.

Natyrisht, nuk ka mundësi që në ndonjë ndodhi të botës të mos ketë personazh shqiptarë. Një natë në këtë shtëpi kishte shkuar një shqiptar për të fjetur. Ia kishte vënë syrin një vajze që i kishte pëlqyer dhe kishte rënë në një dyshek me të. Kah gjysma e natës, kur atij ia kishte marrë mendja se të gjithë kishin fjetur, i ishte ngjitur kësaj vajzës për trupi dhe e kishte filluar atë punë që bëjnë gratë me burra natën.

Por, i gjori e kishte gjykuar gabimisht situatën. Vajza kishte reaguar me grushta për ta larguar mysafirin dashnor të paftuar. Pasi që ishte bërë zhurmë, ishin zgjuar tjerët dhe e kishin rrahur pa hesapë sa që kishte ardhur ndihma e shpejtë për t'ia mjekuar plagët e dashurisë.

Një ditë ky tipi erdhi në restorantin 'Blau Ecke' ku rrija unë. Ende e

kishte fytyrën e mavijosur. Ishte njeri që e njihnin të gjithë dhe ngjarjen që i ishte ndodhur e tregonte pa asnjë kompleks. Asnjëherë nuk kisha parë njeri më humorist dhe me aftësi më të mëdha të rrëfimit.

'Rashë ngat saj dhe dikur ja qita dorën krahëve. Ia preka edhe floktë dhe ajo nuk bajke za hiq. Ma murë menja që pi vjen ujugun. Tani u palova për to dhe kur e qova dorën te brektë e saj dhe kur e diktoj që diçka fort pe prekë prej përmasit, qat'her u qu e ma dha kresë ni rafall grushta. Tani, qështu o burrë, u qunë edhe tjerët m'i ndihmu asaj, thu ti që ajo pak m'ra. Tani krejt me ren sjellshin n'mu'.

'Pse nuk ikshe' - e pyeta.
'Ku me ikë? I pata deshë pantallat dhe i dhashë zor po u rrexova me pantolla nëpër kamë'.

I gjori dukej që nuk e kishte dëgjuar atë thënie tonë të vjetër: 'pelës që nuk ia di hujin, mos ju afro'.

Në fakt, ky rrëfim humoristik përbante edhe anën serioze. Policia e kishte trajtuar rastin si tentim dhunimi por vajza nuk e kishte pranuar dhe më këtë i kishte ndihmuar këtij të gjorit që të shpëtonte pa burg.

'Mirë që ke shpëtua pa burg' - i thashë.

'Pse burg? Kurgja nuk bana' - tha.
I gjori mendonte se në burg shkohet veq kur bënë diçka.



TRANSPORT MALLRASH ANGLI-ITALI--SHQIPERI DHE ANASJELLTAS

Çmime konkurruese dhe shërbim teper korrekt
(për peshat te konsiderueshme i marrim në vendndodhje)

Na kontaktoni

UK 07577974345

AL+355 693455130

IT +39 333581272,



ONYX TILES

TREAT YOUR FLOOR AND WALLS TO THE BEST

Pllaka te te gjitha madhesive
Për shqiptarët dhe bizneset shqiptare në UK
Onyx Tiles Ltd ofrojmë

50% ulje

Tel: 07501 000880



Adresa: Ferry Boat Filling Station Ferry Lane London N17 9NG

MARKU KUNDËR NJË ISH-KAMPIONI BOTE? “DO NDALEJ E GJITHË SHQIPËRIA PËR TË”

Sfida e qershorit e Florian Markut mund të jetë ndaj një ish-kampioni bote, në mënyrë që të afrohet më shumë me kampionin aktual Konor Ben, i cili për momentin refuzon të ndeshet me të.

Këtë e ka pranuar edhe menaxheri i tij, Sem Xhouns, i cili në një intervistë për “Sky Sports” në Angli ka bërë të qartë se po bëhen biseda me ish-kampionin e peshave velter në IBO, Sebastian Formela.

Ky i fundit u mund pikërisht nga Ben dhe nuk është ndeshur më që në nëntor ndërsa po tentohet që të organizohet një sfidë me të, pasi në rast fitoreje, mund të afrohet Markun me duelin e titullit që mbahet nga Ben.

“Ne do të ishim shumë të lumtur të zhvillonim duelin me Formela. Ne ia kemi thënë këtë promotorit Edi Hern. Nëse Florianin do të kishte të njëjtën trajektore si Ben, ai do të ishte në pozita të njëjta me të.

Ben ia bënë gati rrugën, pasi ai nuk garoi në arenën kombëtare. E pres të

fitojë ndaj Vargas në 3-4 raunde. Pastaj shpresoj që Florianin dhe Ben të takohen, pasi do të ishte një event gjigand”, tha fillimisht Xhouns.

Marku vazhdon të jetë i pamposhtur në ringun profesionist dhe emri i tij ka filluar të qarkullojë gjerësisht në skenën e boksit në Britaninë e Madhe e jo vetëm, edhe për faktin se ka një mbështetje të jashtëzakonshme nga tifozët shqiptarë që e ndjekin kudo.

“Ai do të mbushte plot pallatin e sportit “Madison Square Garden” në Nju Jork dhe ky nuk është një ekzagjerim. Nëse do të boksonte në Shqipëri, i gjithë vendi do të ndalej. Do të mbushte arenën “O2” në Londër gjithashtu.



Ai ka një mbështetje të madhe sa më i miri në Angli. Nuk ka rëndësi nëse do që të humbasë apo të fitojë, të gjithë duan ta shohin. Të gjithë kanë një opinion për të.

Të gjithë boksierët e peshave velter në këtë vend po flasin rreth tij”, vazhdoi menaxheri, i cili përveç kësaj mbështetje, është çuditur edhe nga besimi i jashtëzakonshëm që ka Marku se mund t’ia dalë ndaj kujtdo.

“Unë kam qënë në dhomat e zhveshjeve para një dueli me emra si Genadi Golovkin, Horge Linares, Tajson Fjuri, Xho Xhojs. Me Florianin? Është si të jesh duke shkuar në një lokal. Vetëbesimi i tij është i pabesueshëm. Ai është një talent natyral dhe po përmirësohet”, deklaroi menaxheri i boksierit shqiptar. /vipsport.al/



**Akoma nuk
keni një
website?**

**Na kontaktoni:
Adresa e Redaksise:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929
Mob: 073 4066 5946
Mob: 07859 977545**

**Mos hezitoni
të na kontaktoni**





ENVER ROBELLI

“Është e tmerrshme se si flasin njerëzit e afërt me Emmanuel Macron për Kosovën. Kur e përmendim çështjen e vizave, të cilat ende nuk u hoqën për qytetarët e Kosovës, ndonëse Prishtina i ka plotësuar kushtet ngaherë, njerëz të Macronit thonë: ata nuk duan liri lëvizjeje, por duan të vijjnë në Europën Perëndimore dhe të përfitojnë nga sistemi ynë social”. Politikania gjermane i thotë këto fjalë gjatë një bisede telefonike dhe me një kusht: “Gjithçka duhet të jetë anonime”.

Nuk është fshehtësi se Franca është duke e bllokuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Pas një viti, në pranverë të 2022-tës, në Francë mbahen zgjedhjet presidenciale dhe presidenti Emmanuel Macron dëshiron të profilizohet si politikan që

IZOLIMI I KOSOVËS, SAGA E VIZAVE DHE BLOKADA FRANCEZE

kundërshton emigracionin. Në këtë situatë gatishmëria e tij për të hequr bllokadën për liberalizimin e vizave duket e vogël. Së paku tani për tani.

Në Tetor të vitit të kaluar ambasadori i Kosovës në Paris, Qëndrim Gashi, shpërnda në Twitter një artikull të gazetës franceze “Le Figaro”, në të cilin ishin përdorur karikaturat e profetit Muhamed të revistës kontraverse “Charlie Hebdo”. Në Kosovë qarqet radikale islamike dhe badihavxinjtë e mediave sociale humbën kontrollin, edhe Bashkësia Islame reagoi pa pikë nevojë. Në qarqet politike dhe diplomatike franceze këto reagime përforcuan imazhin e Kosovës si “shtet mysliman”.

Fatkeqësisht politika shpesh funksionon sipas metodës së kallëpit: ndodh diçka e pakëndshme dhe një vend i tërë futet në një kallëp të caktuar. Pa marrë parasysh se çfarë mund të mendojmë mbi vlerën artistike të karikaturave të “Charlie Hebdo”, të cilat shpeshherë kanë për qëllim vetëm provokimin, megjithatë nuk është detyrë e imamëve të Kosovës të drejtojnë punët e lirisë së shprehjes në Francë. Ose edhe ndoshta do të ishte sikur të kishin thënë një fjalë të vetme

kritike ndaj represionit brutal kundër opozitarëve në Turqi, në Arabinë Saudite dhe monarki të tjera të Gjirit Perisik.

Në numrin e së martës gazeta gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung” sjell hollësi nga një anketë mbi zgjedhjet presidenciale franceze. Sipas anketës politikania ultranacionaliste Marine Le Pen ka gjasa të mira të kualifikohet për raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Kriza shëndetësore tregon se shumë francezë përqafojnë idetë e Le Pen për izolim, mbrojtje dhe kthim te kombi si mburojë. Instituti Opinionway ka hulumtuar në Francë, Gjermani, Itali dhe në Britaninë e Madhe se si pandemia ka ndikuar në opinionin publik. Për Francën rezultatet janë shqetësuese. 55 për qind e të anketuarve francezë kritikojnë mënyrën si funksionon demokracia në Francë. 65 për qind mendojnë se politikanët e vendit të tyre janë të korruptuar. Shpresa se Macron do të arrijë të kthejë besimin e qytetarëve nuk është përmbushur. Protestat e lëvizjes “Xhaketat e verdha” e kanë shpalosur krizën e demokracisë përfaqësuese. Thellimin e integriteteve europiane dhe hapjen e vendit ndaj botës e

mbështet vetëm një pakicë franceze. 44 për qind kërkojnë mbrojtje më të madhe nga bota që e konsiderojnë të rrezikshme. 63 për qind e të anketuarve e shohin islamizimin si kërcënim për republikën franceze, pra ngjashëm si Marine Le Pen.

Vrasja e mësuesit të historisë Samuel Pety vitin që shkoi ka shtuar ndjenjat negative ndaj myslimanëve. Pety u vra nga një islamist. Macron po përpiqet të marrë rolin e një presidenti që synon të vendosë rend dhe t'i shtyjë myslimanët të jenë pjesë e shoqërisë franceze. Parlamenti francez (Asambleja Nacionale) ka kaluar në lexim të parë Ligjin mbi “forcimin e parimeve republikane”. Synim i ligjit është pengimi i “separatizmit islamist”. Shumica e myslimanëve francezë janë me origjinë nga ish-kolonitë e Francës. Dhe shumica e tyre jetojnë të veçuar nga shoqëria franceze, në zona periferike (“banlieue”), në një botë paralele. Shumë fëmijë nga familjet e tyre nuk edukohen të respektojnë ligjin, por të urrejnë Francën.

Arsimtarët ankohen se gjatë mësimit ngurojnë t'i trajtojnë disa tema (Kurani, teoria e evolucionit, terrorizmi, hebrejtë) për shkak të nxënësve

agresivë me origjinë arabe. Lidhur me këtë problem ka shkruar një libër Inspektori i përgjithshëm i ministrisë së Arsimit, Jean-Pierre Obins (“Comment on a laissé l'islamisme pénétrer l'école” ose: “Si leuam që islamizimi të depërtojë në shkollë”).

Zgjedhjet presidenciale franceze të pranverës së vitit 2022 do të jenë vendimtare jo vetëm për Francën, por edhe për integritet europian. Nga polarizimi i shoqërisë franceze nuk po e pësojnë vetëm kosovarët. Edhe Shqipëria duhet të presë për të filluar negociatat për anëtarësim në BE për shkak të bllokadës franceze. Qëndrim bllokues Franca ka mbajtur edhe ndaj Maqedonisë së Veriut. Sapo e hoqi pengesën Parisi, dolën bullgarët dhe vendosën veto kundër Shkupit për shkak të historisë.

Një fitore eventuale e Marine Le Pen në garën presidenciale do të bënte situatën edhe më të pafavorshme sa i përket integriteteve europiane të vendeve të Ballkanit. Pas zgjedhjeve të 14 Shkurtit politikanët e Kosovës duhet të mbyllin qarkun e polarizimit ekstrem dhe të qeverisin si duhet me vendin për të përmirësuar për aq sa është e mundur pozitën e Kosovës në arenën ndërkombëtare.



Transport Services

UK-EU-ALBANIA
LUGGAGE TRANSPORT
LUGGAGE TRANSPORT

Mentor Muhadri

Strategy Director

info@muhadriltd.co.uk

35 Millmead Industrial Centre
London, N17 9QU
www.muhadriltd.co.uk

+447 884 427 229
+355 692 133 555

Transport Mallrash Angli-Shqiperi & Shqiperi-Angli OFERTA SPECIALE PER NGARKESA TË MËDHA

Per me shume info kontaktoni MENTORIN

UK: 07884427229

AL: 00355692133555,

AL: 00355695798747



Transport Mallrash Dhe Makinash

Angli-Shqipëri-Angli

Çmime konkurrese

Për peshat mbi 50kg

i marrim dhe i dërgojmë

në vendndodhje

Kontaktoni Trashgimin:

Mob: 07727429515 ose 07776106941

Tel: ALB 0686409409, 0683455151

Email: timi29@hotmail.co.uk

BRITANIA HEQ KUFIZIMET NË 21 QERSHOR, UDHËTIMET FILLOJNË PAS 15 MAJIT

Anglia pritet të rivendikoj liritë e saj të privuara nga pandemia më 21 qershor. Ky është objektivi i një plani prej katër fazash që shefi i ekzekutivit britanik Boris Johnson njoftoi në parlament. Sipas tij, shkollat do rihapen më 8 mars ku disa aktivitete jashtë shkollore do rifillojnë më 20 mars, e ku më pas më 12 prill do jetë hapi tjetër për hapjen e dyqaneve joesenciale e salloneve të bukuri, palestrave, librarive, muzeumeve dhe kopsteve zoologjike.

Ndërkohë pubet, restorantet, kinematë, hotelet pritet të hapen më 17 maj së bashku me tifozët nëpër stadiume e koncerte. Pushimet jashtë shtetit dhe udhëtimet ndërkombëtare nuk do i kthehet normalitetit përpara mesit të muajit maj.

Dhe më 21 qershor të gjithë kufizimet ligjore për kontaktet sociale do hiqen, ku do hapen edhe pjesë të tjera të ekonomisë britanike.

Sipas Boris Johnson rruga drejt daljes do jetë e kujdesshme, por e pakthyeshme. Shpresohet se këto masa do mbesin të pandryshuara, nëse do vazhdojë si deri më tani me këto ritme, vaksinimi i popullsisë, nuk do ketë shtim të infektiveve dhe shtrimeve në spitale si dhe nuk



do ketë ndonjë dalje të ndonjë variacioni apo shtamë më të rëndë të koronavirusit.

Gjithashtu një lajm shumë i mirë vjen për tifozët e sportit në përgjithësi dhe futbollit në veçanti.

Autoritetet në Britaninë e Madhe kanë njoftuar se nga 17 maji, do të lejohen 10.000 tifozë në shkallët e stadiumeve.

Në udhëzimin e ri, thuhet se për ngjarjet në natyrë do të lejohen një

maksimum njerëzish deri në 4.000 persona, ose gjysma e kësaj shumë nëse kapaciteti i objektit ku po zhvillohet aktiviteti sportiv është më i vogël.

Por për stadiumet me kapacitete të

mëdha, siç është ai i "Wembley-t", do të pranohen një maksimum prej 10.000 tifozësh. Finalja e "FA" do të luhet përpara datës 17 maj dhe 10 mijë tifozë nuk do të kenë mundësinë të jenë të pranishëm. Federata angleze nuk mund të ndryshojë datën e finales, pasi stadiumi legjendar i "Wembley" do t'i dorëzohet UEFA-s për Kampionatin Evropian.

Pra lajmi i mirë në këtë mes është dhe që ndeshjet e Kampionatit Evropian të futbollit, që do të zhvillohen në "Wembley" mund të mirëpresin 10 mijë tifozë nga etni të ndryshme, megjithatë situata mund të ndryshojë në varësi të situatës së COVID.

Britania ka kaluar dy valë pandemie dhe tre lockdown deri më tani dhe shpresa është se ky do të jetë i treti dhe i fundit, kur e tërë popullsia e rritur e Britanisë do jetë imunizuar deri në fund të korrikut.



**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI - SHQIPERI
DHE ANASJELLTAS**

**Çmime konkurruese, shërbim korrekt
Për pesha të konsiderueshme i marrim në vendndodhje**

07888 908564 0674938913

Grumbullimi

Angli

Londer
Birmingham
Conventry
etj

Shqipëri

Tirane
Elbasan
Belsh
Cerrik, Berat etj



**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI-ITALI--SHQIPERI**

**Çmime konkurruese. (për peshat te konsiderueshme
i marrim në vendndodhje)**

Na kontaktoni

TEL: 07429200952 TEL: 7398236390

AL: 00355682948843

IT:00393206304395

Removal same day delivery

UK & EUROPE

apolloniatransservice@gmail.com



EDMOND TUPJA

O magji e magjive! O mallëngjim i mallëngjimeve! Nuk po resht Edi Rama, ende kryeministër i qeverisë qenësisht qesharake të Republikës tragjikomike të Shqipërisë, së luajturi rolin po aq tragjikomik të Don Kishotit, veçse të një Don Kishoti që vetë Servantesi nuk do ta kishte njohur për të tillë!

Po, o lexuese e lexues të nderuar të kësaj rubrike të përjavshme, këtë rol grotesk ai nisi ta luante kur u vetëdeklarua lypës i shqiptarëve ditën që bëri të ditur se kishte sjellë një dorë vaksina (fucksina?) falë një bamirësi anonim e modest njëherazi, për të cilin, me gjasë, dardha duhet ta ketë bishtin prapa, madje një alamet apo derr bishti!

O Perëndi! Çfarë sakrifice kryemi-

MALLËNGJIM KRYEMINISTROR

nistore, rrjedhimisht çfarë mallëngjimi kryeministor! Ia shkrehu të qarit mbarë populli shqiptar, të cilit vazhdon t'i rrjedhim rrëmbyeshëm lot nga sytë dhe jo vetëm! Lypësi ynë kalorsiak merituaka as më shumë e as më pak çmimin Nobel! E merituaka deri në atë pikë, saqë edhe vetë i madhi e i papërsëritshmi Kadare do të bënte harakiri për të shmangur qoftë edhe më të voglën konkurrencë me atë, madje jo vetëm Kadareja, por edhe ndonjë kandidat tjetër, shqiptar apo i huaj qoftë, do të vepronte bujarisht në të njëjtën mënyrë!

U mallëngjyen edhe miqtë e mi të përherëshëm Françesk Armadhi e Namik Arvogli, por që, me ndonjë rezervë apo ngurrin krejt kalimtar, e adhurojnë nobelistin e ardhshëm Edi Rama, ende kryeministër të shtetit të shtrembër e të shtrydhur shqiptar. U mallëngjyen nga fjalët e këtij se nuk dashka të qëndrojë më në pushtet, ngaqë parapëlqen t'i përkushtohet familjes e veçanërisht djalit të vogël, por, kundër dëshirës së tij si bashkëshort dhe baba, këmbëngul si mushka me afsh përvëlues t'i shërbejë edhe një mandat tjetër popullit të lum-

tur shqiptar për ta shpëtuar atë nga pandemia covid-19 dhe për ta çuar deri në fund reformën e drejtësisë sonë tejet të kalbur!

O Don Kishot i shekullit XXI! Veçse një Don Kishot modern, pa Saço Pançën (Me që ra fjala, ç'bëhet me Erion Braçen, zëvendësin e tij?), pra, një Don Kishot shqiptar, i cili, siç e ka deklaruar vetë botërisht, është gati të shndërrohet – madje tashmë është i tillë – në një lypës të paracaktuar nga Perëndia që të gjejë ku të mundë vaksina (fucksina?) antikovid-19 për bashkatdhetarët e vet. O fjalë e mrekullueshme “lypës”!

Duke u shndërruar në një të tillë, Edi Rama, atje ku Enver Hoxha dështoi me sukses, po krijon Njeriun e Ri, një qenie hibride, pra, edhe kryeministër, edhe lypës pikërisht, duke shtuar e ngjeshur kështu radhët e ushtrisë së lypësve shqiptarë, të cilët, sipas krahnave, njihen edhe me emrat “bonjar, derës, kalander, lamash, lëmoshëtar, lypacak, lyparak, lypsar, përderës, rrahaderë”, etj., etj. Shumëkush, me këtë rast, mendon se së shpejti Orkestra jonë Kuvendore, nën drejtimin e dirigjentit Rama, do ta detyrojë Presidentin e Republikës të sajojë një

medalje të re të tipit “Lypës Nderi i Kombit Lypacak” ose një Titull apo Urdhër të ri të ngjashëm, me qëllim dekorimin me të të Edi Ramës, ende kryeministër lyparak (germat “r” dhe “k” të kësaj fjale të mos ndërrojnë vendet!), por me siguri Ilir Meta, ende president i Republikës, i frymëzuar edhe nga kënga e Bleona Qeretit, mund t'ia refuzojë me motivin “Ti nuk di as me ma lypë!” duke shtuar fjalinë “Për të parë BE-në, këtu hyp!” të ndjekur nga gjesti tradicional me gishtin e mesit të dorës përpjetë!

Nga ana tjetër, admirimi i mallëngjimit kryeministor nga mbarë shqiptarët nëpër botë e, madje – me gjasë – përtej sistemit tonë diellor, arriti kulmin e tij orgazmik kur Edi Rama, ende në krye të qeverisë së tij të bërë qepaze, deklaroi me mburrje e krenari se veten e konsideron gomar, veçse nga ata që, kur e çojnë për ujë, sjell ujë, duke lënë të nënkuptohet se, me shkelma e me pallë, ai do ta vrasë kuçedrën opozitare që ka bllokuar burimin e ujit! O Perëndi, një lypës i kombinuar me një gomar! Jo, gabova, ndjesë: një lypës hipur mbi gomar! O Servantes, ringjallu për të parë e për-

jetuar metamorfozën e protagonistit të romanit tënd! Don Kishoti shqiptar qenka shndërruar në Saço Pançë, por i veshur e i ngjeshur me armët e Don Kishotit tënd! Ai do të bredhë gomarisht për ta përzënë kodosh kodin-19 jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga krejt rruzulli tokësor! Të paktën, o Servantes, paralajmëroje atë të ketë kujdes kur të përdorë ushtën e Don Kishotit zanafillor, sepse mund t'i hyjë në ndonjë vend ku do t'i dhembë jashtëzakonisht, sidomos pas 25 prillit të këtij viti!

Së fundi, por jo më së paku, do të ishte një mynxyrë e papërfytyrueshme jo vetëm për Republikën fatkeqe të Shqipërisë, por edhe për Ballkanin perëndimor, madje edhe për tërë vendet e Bashkimit Europian, sikur Perëndia të bënte gabimisht ose, largqoftë, qëllimisht një tjetër kombinim të lypësit me gomarin dhe që kujt do t'i zinin sytë, në ekranet e vegjële e të mëdhenj, jo lypësin sipër gomarit, por të kundërtën, pra gomarin sipër lypësit, po, po, gomarin duke ia futur bujarisht trutë e veta (trutë dhe aspak ndonjë organ tjetër) lypësit kryeministor!



B M

**Transport Mallrash
Angli-Shqipëri-Angli**

Çmime konkurrese,

Sherbim i shpejtë dhe korrekt

**Për peshat mbi 50kg i marrim dhe
i dërgojmë në vendndodhje**

0771 3888 454

00355 6869 02123



**TRANSPORT MALLRASH
BRITANI - SHQIPERI**

DHE ANASJELLTAS

Çmime konkurrese, shërbim korrekt

Për peshat të konsiderueshme i marrim në vendndodhje



0779611539



0698615790

GRUMBULLIMI BEHET:

Angli

Londer
Sheffield
Leicester
Luton

Shqipëri

Tirane
Durrës
Shkoder
Kukes

JONILA GODOLE

Dikush më pyeti këto ditë se pse “Ditët e Kujtesës” vazhdon të organizohet vit pas viti? A nuk ia kishte arritur tashmë qëllimit? Përse vendosim gishtin mbi plagë, duke i kujtuar shoqërisë të shkuarën e hidhur dhe nuk e lëmë atë të shërohet?

Përgjigjja ime vazhdon të mbetet e njëjtë: Fajin nuk na e ka gishti që plaga nuk mbyllet, por ilaçi që kemi zgjedhur për ta kuruar atë: Harresa e qëllimtë. Kemi qëndruar indiferentë para dëshmiave të dhimbshme të viktimave të diktaturës.

Kemi nënvlerësuar dhe dënuar me heshtje disidentët dhe zërat që sfiduan atë regjim.

Kemi zgjedhur të mos i verifikojmë faktet historike dhe të relativizojmë të keqen, duke e banalizuar dhe bashkëjetuar me të. Kemi neglizhuar verifikimin e figurave publike në lidhje me angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre me regjimin e mëparshëm, duke dëmtuar thellësisht të tashmen dhe të ardhmen tonë.

Mosdëshkimi i krimeve të komunizmit ka një impakt të drejtpërdrejtë në të tashmen, sepse ndihmon në instalimin e një kulture pandëshkueshmërie të klasës politike, se, pavarësisht krimeve që ata mund të kryejnë, askush nuk do t’i detyrojë më pas të mbajnë përgjegjësi. Edhe ligjërimi publik mbetet i ndarë në dy fronte: ish-të përndjekurit politikë, nga njëra anë, dhe nostalgjikët dhe përfituesit e regjimit të shkuar, nga ana tjetër. Në mes janë të rinjtë dhe ajo pjesë e shoqërisë që nuk e sheh veten te asnjëra nga palët dhe kërkon të dijë më shumë, të informohet korrekt për atë që ka ndodhur, por këto informacione e ka të vështirë t’i aksesojë.

Prandaj, “Ditët e Kujtesës” synojnë të sjellin në vëmendje të opinionit publik rëndësinë e përbaljes me të shkuarën përmes dialogut, debatit dhe njohjes me dokumentet arkivore, një pjesë e madhe e të cilave vazhdojnë të mbeten ende të padefinituara. Mosaksesimi i plotë i tyre e vështirëson studimin e thelluar dhe sistematik



të së shkuarës dhe ballafaqimin dinjitoz me të. Ky është një apel për institucionet përgjegjëse dhe një nevojë imediate. Por, ka edhe një arsye tjetër përse “Ditët e Kujtesës” vazhdojnë të kryhen... Sot është data 20 shkurt, 30-vjetori i rrëzimit simbolik të diktaturës.

Unë nuk di të ketë një ceremoni shtetërore për këtë ngjarje të rëndësishme të kujtesës sonë historike. Dhe, për fat të keq, kjo nuk duket si një rastësi. Në Shqipëri, pas 1990-ës edhe festat janë kremtuar të ndara sipas agjendës partiake dhe mbështetësve të tyre historikë. Është e trishtë që organizimet në nder të

kësaj date të vazhdojnë të mbështeten pothuajse vetëm nga institucione të huaja si Fondacioni “Konrad Adenauer”, OSBE, Ambasada Austriake apo Gjermane, ndërsa institucionet shtetërore shqiptare heshtin. 20 shkurti do duhej të kremtohej si ditë zyrtare përkujtimi e revoltës qytetare.

Si një ditë reflektimi për shoqërinë, për të analizuar gabimet e së shkuarës dhe për të garantuar mospërsëritjen e tyre në të tashmen dhe të ardhmen. Sepse, tekefundit, rrëzimi i diktaturës u dha fund jo vetëm vuajtjeve të të përndjekurve politikë, por edhe vuajtjeve dhe izolimit gjysmëshekullor të të gjithë shqiptarëve. Do duhej të

ishite një ditë mirënjohjeje për gjithë ata që guxuan të rrëzojnë statujën dhe bustet e Hoxhës në Tiranë, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë etj., duke vënë jetën në rrezik, ndërsa regjimi vazhonte të ishte represiv. Akti i tyre na frymëzon dhe nuk duhet lënë në harresë. Por, ja që 20 shkurti është sot një ditë harrese kolektive dhe kjo flet shumë për politikën tonë, për shoqërinë, për propagandën kallpe të integritit në bashkësinë e vlerave evropiane.

Jo pa qëllim, moto e edicionit të këtij viti është: A dimë më shumë 30 vjet pas rrëzimit të simbolit të diktaturës? Si ta kuptojnë aktin e rrëzimit me

dhunë të statujës së diktatorit? Si një revolucion nga poshtë, apo si një valvul shkarkuese për zemërimin popullor e komanduar nga lart, nga pushteti i Ramiz Alisë? A ka brezi i ri më shumë informacione dhe materiale si ta analizojë dhe të gjykojë mbi regjimin e kaluar? A kanë dalë këto 30 vjet informacione të panjohura në dritë që të kenë tronditur opinionin publik dhe t’i kenë bërë shqiptarët të reflektojnë se ai regjim duhet dënuar nga të gjithë, dhe me forcë, pa ekuivok? Këtyre pyetjeve dhe të tjerave do mundohemi t’u japim përgjigje gjatë Ditëve të Kujtesës (19-26 shkurt 2021) në një mori aktivitete.

Akoma nuk keni një website?

Si mund të jetë e besueshme një kompani që nuk ka website?



Na kontaktoni
Tel: 020 7018 7929
Mob:
073 4066 5946

D  **Tech**

30 Avenons Road,
London, E13 8HT
Tel 020 7018 7929

www.dotech.uk

DITMIR BUSHATI

PËRTEJ “SHKUNDJES SË PERËNDIMIT”

Një vit më parë, Konferenca Vjetore e Sigurisë së Mynihut ishte ngjarja e fundit ndërkombëtare që ndodhi, para se bota të mbyllej si pasojë e COVID-19. Titulli kryesor i konferencës “Shkundja e Perëndimit” nuk mund t’u shkonte më për shtat fërkimeve dhe tensioneve brenda familjes euroatlantike dhe rendit ndërkombëtar në një botë gjithnjë e më zeropolare. Të premten që shkoi, udhëheqësit botërorë u mblodhën sërish në Mynih, tashmë virtualisht, në një format më të ngushtë, për të diskutuar veçanërisht bashkëpunimin midis SHBAve dhe Europës, në epokën post-Trump. Kësaj radhe me një titull të ri, “Përtej shkundjes së Perëndimit” dhe pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Rusisë dhe Kinës. Një kthim pak a shumë në formatin e hershëm të Mynihut për trajtimin e sfidave të sigurisë brenda hapësirës euro-atlantike.

I. Pjesëmarrësit në Konferencë mirëpritën kthimin e Amerikës dhe kontributin e saj të pazëvendësueshëm për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar. E dëshmuar kjo jo vetëm në mesazhin e përcjellë nga Presidenti Biden, por te rikthimi i SHBA-ve në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimet Klimaterike, sikundër premtimi për të kontribuar me 4 miliardë dollarë në skemën globale COVAX, për të siguruar shpërndarjen e drejtë të vaksinave COVID-19.

ADVERTISING

Duhet pranuar se Pandemia i dha një goditje të rëndë multilateralizmit, duke gërryer më shumë rendin



ndërkombëtar ekonomik dhe treguar në të njëjtën kohë pafuqinë e tij për t’u përballur në mënyrë adekuate me COVID-19 apo ndryshimet klimaterike.

José Saramago në romanin e tij “Verberia” tregon se epidemitë nuk i transformojnë shoqëritë, por ato na ndihmojnë të shohim të vërtetën rreth shoqërive tona. Kështu, shtetet u sollën në mënyrë Hobsiane, ndonëse jo duke drejtuar shpatat mes tyre. Përgjigjja ndaj virusit ishte në të shumtën e rasteve lokale, çka u ilustrua me mbylljen e kufijve, vendosjen e kontrollit mbi eksportet në fushën e shëndetësisë, grumbullimin e rezervave të pajisjeve mbrojtëse dhe politikën e vaksinimit, e cila mbetet e lidhur me nevojat e secilit shtet.

Megjithëse pandemia na shtrengoi të

përfytyrojmë jetesën tonë në një botë të përbashkët, asnjëra prej Fuqive të Mëdha nuk kërkoj zgjidhje në sistemin shumëpalësh. Vështruar në këtë prizëm, konsensusi i Mynihut 2021, i mbështetur në devizën “Përtej shkundjes së Perëndimit”, ka të bëjë me domosdoshmërinë e institucioneve shumëpalëshe dhe një rend ndërkombëtar që bazohet në rregulla të gjithëpranuara, për të trajtuar sfidat me të cilat përballet bota.

II. Pas Luftës së Ftohtë, bota u vendos në një sistem të ri ndërkombëtar të shënuar nga tri forca: gjeopolitike, ekonomike dhe teknologjike. Përkatesisht, epërsia amerikane, tregu i lirë dhe revolucioni në hapësirën e internetit. Të gjithë dukej se punonin së bashku për krijimin e një bote më të

hapur e më të begatë. Luftërat e përgjakshme në ish-Jugosllavi, sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA, kriza financiare globale, kriza e paprecedent e refugjatëve dhe tani pandemia kanë tronditur themelet e rendit ndërkombëtar.

Megjithëse situata aktuale kërkon një vizion të përbashkët, të rrënjësor në vlerat liberale, kjo nuk mjafton për të sjellë ndryshimin e nevojshëm që imponon trajtimi i sfidave të shekullit 21. Krahas konsensusit për nevojën e një bashkërendimi më të mirë të aktorëve kryesorë të familjes euroatlantike në trajtimin e çështjeve kyçe të sigurisë, Konferenca e Mynihut nxori në pah edhe zonat ku interesat dhe përparësitë e tyre ndryshojnë.

Presidenti i SHBA-ve, Biden, propozoi një partneritet të ri me Europën, një aleancë të demokracive në konkurrencë përkundrejt Kinës dhe Rusisë. Më shumë sesa shpalosje e veçantisë amerikane, mesazhi i fortë i Presidentit Biden dëshmoi para së gjithash potencialin e SHBA-ve për të orientuar dhe drejtuar aleancën euroatlantike drejt sfidave të së ardhmes.

Ndërkohë që Presidenti francez Macron vuri në dukje se, SHBA dhe Europa janë aleatë të ngushtë dhe ndajnë një botëkuptim të përbashkët, megjithatë përparësitë e tyre nuk janë gjithmonë të njëjta. Macron kujtoi se, SHBA-të që nga koha e Presidentit Obama, kanë kthyer vëmendjen gjithnjë e më shumë drejt Paqësorisë, ndërsa Europa ka një gjurmë më të madhe në Mesdhe dhe Afrikë. Duke pranuar këtë realitet, Presidenti

Macron u rikthye te tezat e tij për domosdoshmërinë e ndryshimit të “konceptit strategjik” të NATO-s, si kundërpërgjigje ndaj sfidave globale në evoluim të tilla si mbrojtja kibernetike, të dhënat dhe infrastruktura kritike, sikundër nevoja për reformimin e institucioneve dhe politikave europiane, në mënyrë që Europa të fitojë “sovrانيتetin ushtarak”.

III. Konferenca e Mynihut dëshmoi se Europa ndihet më e lehtësuar me Joe Biden në krye të Shtëpisë së Bardhë. Por vetëm një zhvendosje ingranazhesh politike dhe një rritje e retorikës shpresëdhënëse nuk mund të ndryshojë lojën. Sfidat e mëdha globale mbeten aty. Brenda një dekade, çështjet e sigurisë do të jenë gjithnjë e më të mprehta e të lidhura më shumë me ndryshimet klimaterike, të dhënat, inteligjencën artificiale, mbrojtjen kibernetike, infrastrukturën kritike sesa me dislokimin e trupave ushtarakë apo kapacitetet detare.

Megjithëse aleatët mund të mos bien dakord për çdo çështje, ato pajtohen plotësisht për parimet dhe vlerat themelore, të cilat duhen kultivuar, përkundrejt sfidës që vjen prej vendeve si Kina, Rusia apo Irani. Le të shpresojmë se kjo do të përbëjë edhe bazamentin, mbi të cilin do të ripërtërihet lidhja euroatlantike. E në të njëjtën kohë, do të konkretizohet edhe në Ballkanin Perëndimor, jo vetëm si përballje me aktorët e tretë, por mbi të gjitha si një investim për procesin e ngecur të transformimit demokratik, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe anëtarësimit në BE.

ILIR NIKOLLA

Nuk është aspak e vështirë t’i klasifikojmë zgjedhjet tona të 25 prillit si zgjedhje aspak të zakonshme. Jo veç pandemia e kudogjendshme, por para së gjithash një bllokim i plotë i ushtrimit të demokracisë e bën 25 prillin një rast fatlum, një datë të afërt, një takim me historinë që s’duhet të humbet prej propagandës aq efektive të relativizimit, kësaj propagande që mund të themi se ka qenë kolona kryesore mbajtëse e pushtetit të Edi Ramës.

Në mes të butaforisë së lojtarit “global” dhe pashpirtësisë së pushtetarit lokal, bilanci në vigjilje të zgjedhjeve për mazhorancën kuptohet lehtë se është një faliment i përgjithshëm. Lojtarin “global” Rama e lanë në bisht bash atëherë kur propagandës i duhej të regjistronte qoftë edhe një rezultat të vetëm, e lanë në bisht për çështjen e vaksinave. Asgjë s’vlejnë shkrimet e paguara që e krahasojnë Edi Ramën me Turqinë e Greqinë si dikur Ali Pashën me fuqive të mëdha.

Tani shqiptarët po e provojnë në kur-

riz, se edhe kur bota aplikon zgjidhje globale, edhe kur synon njëfarësoj barazie për të gjithë në shpërndarjen e vaksinave, qeveria e “liderit global” s’arrin të bëhet pjesë. Gënjeshtrat mbi vaksinat klandestine të fillimjanarit dhe konferencat me dihatje të kryeministrit javën e fundit, me premtimin “mezi po duroj sa të jap lajmin se vaksinat do të vijnë”, po demaskohen çdo ditë në terren nga shifrat katastrofike të të infektuarve, të të shtruarve në spital dhe të viktimave prej koronavirusit. pesë mijë të vdekur shtesë në statistikat e vitit të shkruar janë një gur shumë i rëndë për t’u kaluar me shprehjen “s’dihet arsyeja pse janë kaq shumë, por s’është provuar se vdiqën prej virusit”.

Analistët pranë Edi Ramës po kapen

si të mbyturit pas fijos së barit, duke deklamuar lart e poshtë e si robotë të porositur, se asgjë s’do të ndryshojë më 25 prill, pasi të gjitha palët janë njësoj e se shqiptarët janë mësuar të bashkëjetojnë me të keqen, prandaj do të zënë hundët dhe do të rivotojnë për kryeministrin. Në ndihmë të këtij “fatalizmi” qatipët e kryeministrit kanë trazuar shkrime të vjetra të Konicës, Fishtës, Çajupit e rilindasve të tjerë, shkrime të cilat e dimë se në ç’kohë u shkruan e për ç’arsye. Synimi është të shkurajohet vullneti për ndryshim, pasi kështu do të ishte më e thjeshtë të kapërdihej edhe çfarëdo rasti që do verifikohet si manipulim i votës. Të mësuarit me të keqen s’do të thotë domosdo se do mësohesh edhe të të vjedhin votën, edhe të të heqin të drejtat të bësh tregti e të lëvizësh i lirë

nëpër qytet, edhe të të rrahin larot e deputetit të zonës, veç se ke qenë aktiv në mbrojtje të pronës e të shtëpisë sate.

25 prilli është një rast i afërt për të konfirmuar se të keqen e kemi duruar, por s’jemi mësuar me të dhe të keqes nuk i japim kurrfarë vlere morale. 25 prilli është një rast për të treguar se hajduti mund t’ia hedhë shtetit e drejtësisë, se mund të ketë edhe ndihmën e pushtetit, por se kurrë me vullnet të lirë s’do të ketë votën e shqiptarit. Njësoj edhe për dallkautin, dhunuesin e mashtruesin. Të përballësh me të keqen është një ushtrim që duhet ta bëjmë vetëm. Në ardhmë ndonjë ndihmë nga jashtë, është e mirëseardhur, por të shumtën e punës, shqiptarët duhet ta bëjnë

vetë. Detyrimi ynë kombëtar është izolimi i keqbërësve dhe shpallja hapur e vullnetit për ndryshim. Këtij detyrimi duhet t’i dalim në takim më 25 prill, si blatim për përpjekjet e rilindasve të vërtetë për ta rikthyer Shqipërinë në Perëndim, por edhe si premtim se demokracia shqiptare s’është më aq e brishtë sa thuhet e se asnjëherë në të ardhmen, s’do të lejohet që xhahili të bëhet mbret e qehajallarët të ndajnë pushtet.

Sfida e ndarjes së shtetit nga hajnia s’është një betejë e re, atë e kanë fituar shumë demokraci më të vjetra se ne dhe sot renditen ndër shtetet me mbrothësi, prandaj s’ka pse 25 prilli të mos përjetohet si një sfidë për çlirimin e shtetit nga segmentet e hajdutërisë.

SFIDAT E NDARJES SË SHTETIT NGA HAJNIA

NDRIÇIM KULLA

Shqipëria po ikën. Ashtu ngadalë, pa u ndjerë, pa bërë zhurmë e pa përplasar derës e shtëpisë së vet të madhe. Por përsëri po ikën.

Duhet sakrifikuar për të ardhmen e fëmijëve, të thonë, sikur duan të heqin nga supet barrën e rëndë që u lë mbi shpatulla egoizmi. Po e ardhmja e tyre, e familjes, e vendit që lënë pas, nuk është një barrë akoma dhe më e rëndë për t'u mbartur e për të mos u lëshuar? Ai është kryqi ynë, të thonë, kalvari që duhet të vuajmë përbrenda. Është, me një fjalë, ferri nga i cili nuk kemi për të shpëtuar dot kurrë.

Ky është lumi i mendimit që duket se po rrjedh nëpër mendjet dhe zemrat e shqiptarëve që po ikën e po e shpopullojnë tmershem këtë vend. E si pritë ndaj gjithë kësaj katastrofe vendoset ndjenja e patriotizmit, atdhetarizmit, fjala e patriotit.

Në të vërtetë fjalë të tilla nuk janë të përputhura ende mirë me kuptimin e tyre në jetën shqiptare. Duket sikur janë në thelb fjalë shumë të mëdha, që kanë një përgjegjësi aq të rëndë sa askush nuk guxon ta përballë. Janë bërë fjalë të ditës, përdoren

kudo, kanë lloj-lloj ngjyrash, gjithëfarë fytyrash, kuptimesh, zërash!

E megjithatë nuk duken të jenë aq të sigurt për t'u përdorur si pendë shpirtërore që do të ndalojnë vërshimin e zhgënjimit, varfërisë, padrejtësisë. Janë kaq të trazura shkaqet që i bëjnë njerëzit të mendojnë dhe veprojnë në çdo rast kështu apo ashtu, madje janë aq të trazura saqë s'mund t'ia dalin mbanë edhe ata vetë. Por të them të vërtetën nuk më mërzi aspak kjo gjendje. Përkundrazi më bën të reflektoj për një mendim krejt tjetër.

Tanimë që duket sikur kemi arritur fundin, sikur po jetojmë dhe po shohim në sy ferrin, i kemi të gjitha shkaqet të shkundemi e të zgjohemi nga ëndrra e keqe e arratisë dhe të mendojmë se përveç ferrit Shqipëria është edhe parajsja jonë. Është ai vendi i bukur, i mrekullueshëm që vështirë se mund ta gjejmë dot në mërgim. Është ajo sofa e varfër, por ku shtrohet buka e ngrohtë e bujarisë dhe hahet kripa e shijshme e solidaritetit njerëzor, e njerëzve që flasin të njejtën gjuhë e që kanë të njëjtat za-

kone.

Askush nuk mund ta mohojë nga të gjithë ata që largohen se nuk u mungon Shqipëria, madje dhe balta e saj, atje larg ku janë, se ç'u krijon një afinitet të menjëhershëm që nuk u shlyhet me asgjë tjetër. E megjithatë, nuk është vetëm kjo ndjenjë e mallëngjimit, le të themi edhe e romantizmit historike, ajo që na e bën aq të parajstë Shqipërinë përpara syve tanë të mendjes e të zemrës. Ne jemi ose bëhemi shqiptarë vetëm duke rrojtur në mes të Kombit tonë. Rrojmë, jo për Kombin, por brenda Kombit. Pse t'a lëmë?

E kushdo që e zotëron këtë ndërgjegje të Kombit, ndjen se të gjitha mendimet e veprimet e tij i ushtrohen vetvetiu nga një farë disipline. Aq më tepër që çdo ndërgjegje e bën njeriun më të mirë si njeri, pasi vetëm ai që e ndjen thellë kombësinë e vet mund të ndjej thellë edhe kombësitë e tjera. Ja, një pikë e fortë mbështetjeje, ku mund të kapet çdo shqiptar që ka marrë rrugët e mërgimit në emër të së ardhmes, në emër të fëmijëve.

Është më e sigurt, më e dobishme, më e përshtatshme që këtë të ardhme ta ndërtojë këtu, me ndërgjegje, forcë e vullnet, sepse vetëm ajo do t'i bëjë më të mirë, më të dashur në jetën e përditshme, e pse jo dhe më të lumtur, edhe vetë fëmijët e tyre. Po përse vallë mund të jetë kaq e fortë kjo lidhje për t'u kthyer në një barrierë?

Njeriu dhe kombi janë dy kuptime që plotësojnë njëri-tjetrin. Njeriu përfaqëson të gjitha fuqitë e kombit të vet. Ëndrrat e tij janë ëndrra të kombit dhe shpresat e kombit janë shpresat e tij. Nëse kombi i humb shpresat, i takon njerëzve të vet që t'i dhurrojnë ëndrrat e tyre. Dhe përsëri prej tij të marrin shpresë, sa herë të dëshpërohen. Këtë gjë duhet të bëjnë sot edhe shqiptarët për kombin e tyre, pavarësisht se mund të duket paradoksale, pavarësisht se mund të duket një sakrificë shumë e madhe për t'u marrë përsipër.

Është e kundërta, sakrifica më e madhe është jeta në një vend të huaj, pa atë rrjetën e lidhjeve mendore dhe shpirtërore që çdo vend i fal njerëzve

të vet, në çdo rast që ata ndihen të lodhur, të depresuar, me sytë e lidhur nga fashoja e trashë e pesimizmit dhe mungesës së shpresës. Ndoshta materialisht mund të jenë më mirë, më të qetë, por parajsja dihet, është shpirtërore, dhe shpirtërisht ferri ekonomik nuk mund të zëvendësojë, e as të suprimojë dinjitetin dhe moralin njerëzor, paqen me detyrat dhe përgjegjësitë, që çdo njeri provon në raport me të ardhmen e kombit të vet, që duhet të bëhet njësh me të ardhmen e fëmijëve tanë.

Ndaj, edhe nëse sot shohim se mund të jenë verbuar sytë e Kombit tonë në emër të të gjithë atyre njerëzve që u dorëzuan dhe nuk arrijnë t'i shohin dot fuqitë që gjenden brenda tij, duhet të jetë unifikimi i kësaj të ardhmeje ai që duhet t'u tregojë rrugën këtyre njerëzve që të shohin me sytë e kombit të ardhmen e fëmijëve të vet, sepse kështu do të arrijnë t'ia dallojnë më mirë dhe më bukur pasuritë, vlerat dhe mrekullitë asaj parajsje shpirtërore me emrin Shqipëri.

FADIL LEPAJA

Para këtyre zgjedhjeve, PDK kishte mbetur pa kreun e saj e LDK pa flamur. Të parët shkuan në Hagë "me mbrojtë lirinë tonë", e të dytët, pra "flamurin e rugovizmit", e mori Vjosa me vete, në rrugëtimin e saj me Vetëvendosjen. E mori për me e "mbrojtë" nga rugovistët.

Prej këtij pështjellimi, si pasojë, LDK u dërmua, PDK ra në gjuhë dhe u dorëzua, ndërsa vota qytetare shkoi te Albini dhe Vjosa. U quajt shkurt: "Vvota". Për shembull një vajzë duke qeshur, po thoshte: "unë VVotova". Një tjetër po shkruante në profilin e saj: "VVota ime"...

Përndryshe, nuk kam pasur titull më të shkurtër ndonjëherë për një shkrim. Nuk kam pasur as shkrim që duket kaq i anshëm, edhe pse nuk është i anshëm.

Thjesht ndonjëherë është e vështirë të mos shprehet damari popullor që po rrahë nën rrobat e trasha të dimrit. Përpiqem me ndjekë logjikën e argumenteve e jo vrullin e emocioneve, edhe pse shkrimet pa emocione janë sikur përkthimet në Google.

E shkrimet e tilla lexohen veç prej zori, e jo me afsh, jo ashtu si hahet një hamburger për shembull. Kuptohet, nuk po e promovoj ushqimin e shpejtë këtu, as mediat me qasje jo të shëndetshme, por... t'i kthehem titullit se populli është në dietë.

S'ka dyshim se titulli është me dy kuptime. Në rregull, ndoshta i ka më

shumë kuptime, por ka potencë me shprehë frymën. Mënyra më e mirë për me e bë frymë dikë është me e kontestua kur ti vet publikisht je i denoncuar si i keq në rrëfim. Ishte bartës i listës dhe e ndaluan, kështu e bënë frymë. Rrëfimi për të pastaj ishte përfolur gjatë nëpër kafene, oda, zyra, shëtitore, nëpër ara të bukës, pra kudo, përveç në mediat "e lira" dhe në institucione.

Pra, është veç një fjalë që i përshkruan zgjedhjet e kaluara, sidomos atmosferën dhe përmasat e kësaj lëvizjeje e cila u formësua pa ndonjë fushatë kushedi çfarë elektorale,

madje nuk kishte as shkuarje nëpër mediat "e mëdha" sidomos te disa të cilat u përfolën edhe nëpër raporte ndërkombëtare. Vet i quajtën mediat e tyre, të lira, sepse edhe atyre ua sollën lirinë sikurse edhe ne.

U kuptua se lirinë nuk e patën gjete mes nesh, por e patën sjellë. Prandaj, ata që na e sollën lirinë, tash po i marrin nëpër gjykata dhe ne na mbeti vetëm liria. Ata që shkuan "me Çlirimtarët", nuk e kaluan pragun. Ka konfuzion të përgjithshëm lidhur me pyetjen e famshme, kadariane: Kush e solli...lirinë!

"WOTA"



hidhin një gurë mbi mëkatarrët të cilët na kishin prishur me ndërkombëtarët dhe po na kthenin në komunizëm.

Kështu po na "ndihmonin" me kuptua rrezikun që sillte liria, me të cilën nuk jemi mësuar ende këto njëzetë vite dhe mund të lëndoheshim me të si me një lodër të rrezikshme. Mohimi i të drejtës për kandidim për bartësin e listës së Vetëvendosjeje, ishte veç guri i parë, drejt mëkatarrëve, por padyshim ishte guri i fitores së tij. Prej udhëheqësit të listës për ndryshime, e bënë udhëheqës shpirtëror të ndryshimeve.

Tash, ishte ndihmë e pritur. Na kanë "nimue", qe 20 vjet! Nejshe, këtë titull meqë e nisëm me të, nuk e solla unë. E gjeta në rrjetet sociale, si një status i cili njëkohësisht fshihte dhe tregonte se për kë kishte votuar autorja. "Vvota ime" e kishte shkruar ajo, shoqëruar me një zemër të kuqe!

A do të mbetet vota e saj, jehona e një fushate, një mbrojtje me heshtje para sulmeve të atyre që historia po i tërhiqte teposhtë, dhe tjerët po i ngriste, mbetet të shihet! Gjithsesi një faqe e re e historisë tonë më të re është hapur dhe shpejt do të shohim rreshtat e parë të shkruar...!

Ndërkohë, nëpër rrjetet shumëkush ka ide që 14 shkurti të shpallet si data e çlirimit të dytë të Prishtinës. Apo ishte i tretë?

Ishte një fushatë kundër "Vvotës", e përmasave të papara ndonjëherë ndër ne, ku të gjitha partitë përpiqeshin të

LOER KUME

PËRMES PASQYRAVE TË KADARESË

I detyrohem Kadaresë për dritaren e madhe të letërsisë që më hapi me “Kush e solli Doruntinën”, herët, në bankat e gjimnazit. E, më pas, me shumë vepra të tjera. Dhe ky shkrim i ngacmuar nga libri “Kohë për rrëfim” është një refleksion për rëndësinë që ka shkrimtari në një shoqëri. Lashë të kalonin disa ditë pas leximit për të përmbledhur mendimet, njohjen që m’u dha mbi këtë njeri plot ambiguitete, që tashmë në histori është kthyer në personazh.

Kadare është i përkëdhelur. Me një jetë midis banketit, vetmisë, dhe të mbajturit ekuilibër mbi humnera, ai është përkëdhelur nga lexuesit, admiruesit, miqtë, pushtetarët, nga gratë dhe nga bota. Kadare ka bërë një jetë në majat e jetës. Një për kujtimet dhe udhëtimet mendore të nxitura nga pyetjet e Bardhylit, nëpër skutat e ertëta të epokave që ky shkrimtar ka jetuar, ka pasur vetëm një fener në dorë: talentin e tij. Kadare spikat si poet që në shkollë. Në një kohë të çoroditur të pasluftës, në një periferi si Gjirokasta, por provincë plot kulturë. Sa për kujtesë, edhe Çerciz Topulli, që të rinjtë sot e mbajnë në bluzë si një luftëtar liric, Guevara shqiptar, ka qenë së pari intelektual i kohës, i eklipsuar mbase vetëm nga vëllai Bajo, e nga miku i ngushtë i armëve, Mihal.


Kadare në këtë provincë spikati. Por, spikati edhe më fort në Tiranë. Në Tiranë, ky shkrimtar nuk ishte i biri i dikujt, nipi i dikujt, nuk ishte miku i askujt, por vetëm një talent letrar. Filimisht si poet, pastaj si prozator, Kadare shkëlqeu krejtësisht ndryshe, diçka krejt moderne, e freskët, e thellë, thurje e shqiptarisë komplekse me botën e jashtme.

Kadare i ri dallohet për letërsinë e tij me mënyra krejt të reja në një terren artistik të vështirë e të papërpunuar në Shqipëri, që pas bumit të viteve ’30, në vitet e pasluftës, e më pas, nën dirigjencën diktatoriale pllakosi shkretia intelektuale. Mënyrat e tij letrare janë edhe sot shumë moderne. “Përbindëshi” më ka habitur me mbivendosjen kohore; “Ftesë në studio”, një vepër supermoderne, sa për të përmendur dy nga krijimet e shumta të freskëta edhe sot.

Pikërisht me këto mënyra shkrimi, nga ky talent letrar, ai bëri emër dhe lexuesit nisën ta adhurojnë. Autorë të rinj ta imitojnë. Vetë Hoxha e telefonon në Lidhjen e Shkrimtarëve për ta përgëzuar për poemat e tij.

Kadare, në sajë të aftësisë së tij për të lëvizur nëpër kufijtë e situatave dhe dogmës, nxjerr avantazh nga sistemi i kohës, botohet jashtë, shkon në Paris si eksporti ynë më i mirë intelektual, shëtit, jeton bukur, përkthehet në gjuhë të tjera, femra i shkruajnë letra, ai merr avantazh ndaj tyre.

Në pasqyrat e erotikës, Kadare çiltërsisht, me moskokëçarjen që i jep statusi dhe mosha tashmë, na rrëfen se shkrimtari Kadare vetëm prift nuk ka qenë. Duke qenë magneti i kulturës shqiptare të kohës, vëmendja femërore nuk paska munguar në ato vite. E në ato vite flirtohej e bëhej seks. Madje, nga sa na rrëfen në libër, përfiton edhe



ndaj vajzës së një të njohuri të tij, njërit nga njerëzit më të fuqishëm të sistemit të dikurshëm. Dhe pas pasqyrës së çiftit Kadare lexojmë për tolerancë. Shumë tolerancë. Dhe qejfe, shumë qejfe. Dhe pse jo? Jeta është e bukur kur ke talent dhe zgjuarsinë për të shfrytëzuar momentet e tua. Ky duhet të jetë model për të rinjtë e sotëm, që ngadalë po kthehen në kukulla “Barbie” në prerje serie me hekurosje të njëtrajtshme të rrudhave të kontekstit.

Ka qenë fati i madh i Kadaresë, që ka jetuar dhe krijuar në kohën kur letërsia në Shqipëri ishte subjekt kryesor i interesit publik dhe dëshirave të njerëzve, ndryshe nga koha e sotme. Këtë fat e ëndërrojmë sot dhe ne, do ta ëndërrojnë shkrimtarët në tërë kohën që vjen, por janë të vështira prerjet e rrethanave. Nga rrëfimi kuptojmë çfarë rëndësie kishte letërsia dhe brenda mureve të izolimit dhe varfërisë, sa të prirur ishin shqiptarët e atëhershëm drejt kulturës dhe sa të gjynahshëm janë sot në liri të plotë, në djerrinën e shkretët që u kanë krijuar përreth, me telenovela, libra rozë, emisione televizive llumore dhe ekrane telefonash nga ku nxjerrin kryet dhe këpucët lloje e soje politikanësh, që pas disa vitesh do t’i qeshë historia.

Feneri i talentit që e çon përpara shkrimtarin, gjithashtu nxit xhelozitë e krijon kundërshtarë. Pikërisht këtu është pika e lidhjes së ambiguitetit të Kadare. Nxitja e urrejtjes nga ana e urrejtësve. Nga ana tjetër e pasqyrës, kjo përkëdhelje, kjo ngjitje drejt majave, ka provokuar gjithashtu zili, urrejtje, gjuajtje me gurë si majmunët gjuajnë sendet që nuk i kuptojnë ose krijesat që kanë frikë. Kështu, na krijohet një panoramë plot me pasqyrime, e shformime iluzore të një pasurie artistike e intelektuale dhe të perceptimeve ndaj saj.

Pse jo, në fakt, pse të mos kishin zili e kundërshti, në një kohë që shqiptarët vuanin diktaturë të tmerrshme, ky njeri gëzonte privilegje që askush s’i kishte?

Por, nga pas pasqyrave të Kadaresë lind një pyetje pak më e thellë se du-

alizmat moraliste i mirë-i keq; përse artisti nuk duhet të shfrytëzojë statusin dhe pozicionin e tij për të jetuar më mirë? Cili është problemi? Pse kërkohet prej shoqërisë shqiptare gjysmë puritane, gjysmë skandaloze, gjysmë thashethemexhi, gjysmë symbyllur, gjysmë përputhur, e gjysmë osmane Sulejmane, gjysmë feministe e gjysmë moraliste, që artisti të vuajë, të torturohet, të kundërshtojë, të kalbet burgeve, të mos shkëlqejë, të mos krijojë shfaqjen e tij artistike? Pse kërkohet kryq popullor mbi shpinën e artistit kur ai bart me vete gjithmonë kryqin e artit ndërkaq?

Ndaj, duke lexuar rrëfimin e Kadaresë përmes Bardhylit, kuptova me shumë, për kohën e diktaturës, dhe akoma më shumë, e më qartë për këmbëzën e thjeshtë të armës ndaj Kadaresë dje, ndaj Johny Depp sot, shkrepjen e armës ndaj çdo artisti për ta dënuar dhe kryqëzuar në atë kohë e në këtë kohë. Duke i kërkuar llogari për mëkatet popullore, duke i vënë pas murit për moralin e vitrinës sociale. Po ç’quajmë moral, a dimë ta themi? A ka moral popullor?

Por, të kthehem te Kadare.

Në 1980, Marina Abramovic dhe Ulay realizojnë një performancë që quhet “Rest energy”, ku të dy tendosin me peshat e trupit një hark me një shigjetë drejtuar në zemër të Marinës dhe mbajtur nga Ulay. Edhe pse idetë janë krejt të kundërta, nuk ka skenë më ideale për të përshkruar raportin e Hoxhës me Kadarenë. Pavarësisht nga çfarë thotë Kadare, pavarësisht nga çfarë ka gjetur Bardhyli në arkiva në ditarin e Hoxhës mbi opinionet e tij për Kadare, mendimi im personal është që të dy këta entitete, në atë kohë funksiononin si alterego të njëri-tjetrit. Edhe pse Kadare e përbuzte diktatorin si çdo njeri i kulturuar në këtë vend, sepse gjithkush që nuk kishte perde në sy kuptonte injorancën dhe natyrën e pastër keqberëse të diktatorit.

Por, kush nuk do joshej vallë nga një pushtet absolut? Kush nuk ka atë kohezionin e çuditshëm ndaj një lideri absolut, kushdo qoftë ky, pushtetit absolut që të ka në dorë jetën dhe vdek-

jen?

Hoxha, nga ana tjetër, e sheh shkrimtarin si alteregon e tij, një vete e një realiteti tjetër, të lirë, një vete gjeniale, arrakate, që nuk duhet t’u bindet peshave të të qenit komandant suprem, por është i lirë të krijojë, të jetojë e gëzojë. Hoxha joshet e magjepset nga letërsia e shkrimtarit. Ndaj krijon një zakon tolerance ekstreme ndaj tij. Shkrimtari e kupton këtë dhe luan me këtë fakt, e shijon, e përdor me saktësi kirurgjikale. Kështu lind loja e harkut të Abramovic – Ulay, një tension që Kadare e shijon, e vuan gjithashtu, e gjejmë në rrëfimin e motrës së tij, derisa i kthehet në zakon sasia e adrenalinit ndaj këtij raporti. Kështu dhe vetëm kështu, duke paguar haraçe të vogla, e duke i shlyer ato me vepra si “Pallati i ëndrrave” e “Përbindëshi”, ne arrijmë të kemi sot e kësaj dite një opus letrar nga me uniket. Sigurisht, Hoxha është gjenial në errësirën e tij, dhe kurrsesi nuk do ngjallte vëmendjen e botës së jashtme duke burgosur një shkrimtar të njohur si Kadare, ndaj sërish loja e harkut solli një rezultat të ri, një fitore të re, një shkallë të re adrenaline në regjimin më mizor e absolut në Europë. Burri i mençur diti të luajë me pushtetin për të nxjerrë përfitimet e tij e jetën e tij.

Në kohën e sotme, intelektualët e telikosur u shkojnë pas drejtuesve politike të momentit metribute çapaculësh, për një kafshatë bukë, e po kjo kategori njerëzish ngrenë struktura morale ku të gjykojnë artistin dhe artistët mbi parime të moralit fetar.

Në optikën time, talenti i Kadaresë është formuar nga ambienti ku është rritur. Secili shkrimtar rritet dhe prodhon atë që e ushqen. Unë jam produkt i rrëmujës, i kaosit shqiptar e i qytetit të Durrësit, Tiranës e botës së 30 viteve të fundit, Kadare është produkt i Makbethit, thashethemnajës së qytetit të gurtë dhe, si rrëfen vetë, i Moskës, dhe neverisë ndaj shkrimtarit të buzëqeshur, skematik, antiletrar, sovjetik, që pa të prodhohej masivisht në Moskë. Stili i tij i përngjan mjegullës, supozimeve, pëshpëritjeve, fjalëve që qarkullonin ashtu si

magjishëm nga një sokak në tjetrin, nga një prag dere në tjetrën, përmes plakave, orteku i fjalës merrte përmasa titanike, vdekjeprurëse. Kështu u mbryjt drama dhe tensioni i stilit të Kadaresë. Cikli i Gjirokastrës na jep një nga letërsitë më brilante dhe nga të rrallat letërsi me humor në gjuhën shqipe. Sigurisht, do doja shumë që Kadare dhe autorët e krijuesit shqiptarë të ishin më të hapur me letërsinë perëndimore, të dëgjonin muzikën që ndryshoi botën, të shihnin pikturat që ndryshuan mendjet, të rrihnin ide e shkëmbenin letra dhe teknika me bashkëkohësit e tyre nëpër botë. Kjo mungesë dashje pa dashje solli njëfarë ngurtësie të temave dhe te Kadare, në opinionin tim, solli shndërrimin e shkrimtarit në një Sofokli, autor gjysmëperëndish. Nuk di të them kush saktësisht është Eskili, por Sofokliu – Kadare do ta lëshojë hijen gjerë e gjatë me kohën që ikën, në letërsinë europiane e botërore.

Kemi mundësinë të lexojmë këtë rrëfim fantastik të shkrimtarit në këtë një libër sot dhe nuk do ta kishim nëse nuk do ishte për këmbënguljen, durimin dhe qetësinë për të komunikuar disa vjet me Kadarenë e ngopur me vëmendje dhe gazetarë, rrënimin dhe nxjerrjen në dritë të rrëfimeve përmes pyetjeve dhe stërpjeteve të Alda Bardhylit. Dua të shkruaj disa fjalë mirënjohje për punën e saj, sepse njerëzit zakonisht kompleksohen nga puna e tjetrit, ose sulmojnë e gjuajnë me gurë si majmunët që përmendëm, ose nuk flasin një fjalë të mirë për shkak të detyrës drejtuese të Bardhylit, për të mos u dukur qokaxhinj e qejfbërës.

Bardhyli ruan një profil të ulët, nuk del me flamur e shpatë në kryqëzata për të prezantuar veprën e saj si bëjnë autorët e tjerë me dy paragrafë libra. Por, në sajë të punës së Bardhylit si autore, sot kemi librin me rrëfime të Kadaresë, dosjen e zbardhur e të rrëfyer të Maks Velos, kemi përkthimin e letrave të Simone de Beauvoir me poetin amerikan Nelson Algren, kemi “Bisedë në dy kohë” me Ardian Civicin, që është një pasuri e vërtetë për studiuesit, dhe bisedat me Kim Mehmetin, një kuriozitet shumë interesant mbi një personalitet si Kim Mehmeti e mbi realitetet të dopiuara si Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova. Duhet disa tipare e disa kritere të caktuara për të qenë një gazetar e studiuese e plotë, duhet ekuilibër, qetësi, gjerësi mendimi, mirëkuptim e gjithëpërfshirje. Dhe, mbi të gjitha, shumë dashuri për artin. Dhe këto tipare janë gjendur herët në kulturën e Bardhylit, në dukje nonchalante, por në thellësi, me shumë zemër.

Në fund, po, Kadare është një i përkëdhelur, por asgjë më shumë se dëshirat tona më të thella për përkëdhelje e llastime. E kush nuk do të donte të shkëlqente.

MUHARREM SALIHU

A ekziston një mundësi e vetme, që shqiptarët në Kosovë dhe Shqipëri, gjegjësisht dy shtetet tona të ndalin genocidin e heshtur ndaj bashkëkombasve të tyre në Luginë, e që në Medvegjë, ka arritur kulmin? Unë besoj se po, sepse unë besoj tek forca e shqiptarëve të bashkuar. Unë besoj se nëse shqiptarët bashkohen, askush nuk mundet t'i bëjë ballë në rajon. A nuk është ky një mesazh që na vjen nga koha e Skënderbeut?

Mirpo që shqiptarët të bashkohen, do duhet të kuptojnë se ku kanë gabuar. Vetëm atëherë mund ta gjejnë atë zgjidhjen e duhur, që ta ndalë atë që unë e quaj genocid ndaj bashkëvendasve të mi.

Ja pse ndaj nesh po bëhet genocid. Sipas krijuesit të kësaj fjale, Rafael Lemkin, genocidi është “ një plan i koordinuar veprimesh që synojnë shkatërrimin e themeleve qenësore të jetës së grupeve kombëtare, me qëllimin që t' i asgjësojë si të tillë. Më konkretisht objektivat e genocidit janë dizintegrimi social dhe shkatërrimi biologjik, nëpërmjet... teknike politike, sociale, kulturore, ekonomike, biologjike, fizike, fetare dhe morale që godasin pasurinë identitare të një grupi minoritar.”

Unë sfidoj këdo, që të mos identifikojë në këtë përkufizim atë që serbët na kanë bërë ne që në vitet 1870. Teknikat ndryshojnë, por qëllimi mbetet i njëjtë që nga Cubrilloviqi e këtëj: Asgjësimi ynë nga territori që na kanë lënë të parët.

Kur të pasivizohet adresa, kur nuk ke mundësi të kthehesh sa herë të duash dhe nga të duash, kur nuk pajisesh me kartë identiteti, kur nuk voton dot, kur të dekurajojnë të vizitosh tokën tënde, të mbrosh të drejtat e tua civile, kjo është teknikë genocidale.

Kur Medvegja që është gjysma e Luginës të zbrazet dhe nga ata pak rezidentë të etnisë shqiptare, atëherë qëllimi i përhershëm genocidal serb është arritur.

Gabimet tona

Mirpo mos prisni të vajtoj duke sulmuar të tjerët si bëjmë ne shpesh në histori. Fajin e kemi vetë ne. A nuk janë shqiptarët e Luginës, që po mpaket, të ndarë, të përçarë, në disa taborre që sa vinë e shtohen?

A nuk vjen kjo pse “ të ashtuquajturit liderë të tyre”- në fakt “prijës mëhalash të vogla” luftojnë ata njeri tjetrin me egërsi më të madhe sesa luftojnë serbët në mbrojtje të popullit tonë? Pse ata i duartrokasin, heshtin, apo mbështesin politikën serbe, të pastrimit të Medvegjës në fillim, ku gjenden burime të rëndësishme minerare dhe ujore?

Pse besojnë naivisht se radha nuk do t'u vijë atyre, apo që pas

SHTETËSI E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË PËR LUGINASIT. TË ULIM KOKAT E LIDERËVE NËN FLAMURIN KOMBËTAR



pastrimit të Medvegjës është radha e Bujanovcit dhe Preshevës?

Më lejoni të flas pak për Kosovën deri më tani. Prej çlirimit të Kosovës, mijëra luginas janë vendosur në territorin e saj. Pa status, pa dokumenta deri para pak muajsh. Kosova nuk bëri atë që bëri Serbia me të shpërngulurit serbë nga territori i saj, të na trajtonte si refugjatë, të kërkonte mbështetjen e Bashkimit Europian, dhe të aplikonte parimin e reciprocitetit ndaj tyre.

Në dialog nuk është imponuar dot asgjë.

Shqipëria nga ana e vet nuk ka mundur të ndalë këtë që po ndodh, ndonëse marrëdhëniet midis shtetit amë dhe Serbisë janë normalizuar. Jam kundër atyre që thonë se këto marrëdhënie duhet të prishen, sepse kur nuk komunikon me fqinj, atëherë nuk zgjidh asgjë. Mirpo në terma realë, as diplomat nuk janë njohur dhe pasivizimi i adresave, diskriminimi etnik në përgjithësi nuk është denoncuar si duhet, veçanërisht ndërsa Shqipëria udhëhiqte OSBE-në. Zgjedhjet në Kosovë. Pse duhet dhënë shtetësia e Kosovës ose e Shqipërisë, menjëherë pas zgjedhjeve

Kosova ka zgjedhur të maturohet si shtet edhe nëpërmjet zgjedhjeve, andaj në 12 vjet janë bërë 6 palë syresh. Mirpo le të përfitojmë nga energjia që prodhojnë ato, për të korrigjuar gabimet e rënda të së shkuarës. Krejt forcat politike duhet të bien dakord rreth një sërë hapash imediate që duhen ndjekur për të ndaluar shpërngulimin e Luginës. BASHKIMI BËN FUQINË. Duhet shikuar mundësia e dhënies së shtetësisë kosovare, bashkë me karta identiteti, por me adresat e Luginasve dhe shqiptarëve të Serbisë, atje në Republikën fqinje. Kjo bëhet

njëjtë si Serbia: për arsye humanitare. Duhet përdorur në dialog parimi i reciprocitetit mu për shqiptarët e Luginës vis a vis serbëve të Kosovës, në territorin e saj apo të zhvendosur në Serbi.

Këtë veprim mund ta bëjë edhe Shqipëria. Kjo don të thotë se dy shtetet shqiptare veprojnë njëllor dhe nuk mund të atakohen veç e veç nga Bashkimi Europian apo Serbia. Është dritëshkurtër arsyetimi sipas të cilit kjo do të nxisë largime të vullnetshme nga Lugina.

Dhënia e shtetësisë njëkohësisht ose nga Kosova, ose nga Shqipëria, (sipas preferencës), është akordim i mbrojtjes ndërkombëtare të shqiptarëve të Serbisë; është ruajtje e identitetit të tyre; është konsolidim i lidhjeve me tokën e tyre, është akt fuqie i kombit shqiptar të bashkuar.

Është shpresëdhënëse se kandidatët e

Luginës në këto zgjedhje e kanë përfaqëuar këtë qasje. Kam patur biseda me krejt udhëheqësit e partive të Kosovës, të cilët më kanë garantuar për mbështetjen e kërkesave tona. Vetëvendosja ka më shumë kandidatë të Luginës se tjerat në këto zgjedhje. Mirpo Shqipëria dhe Kosova duhet të bëjnë dhe diçka tjetër me çdo kusht. Të jetësojnë të ashtuquajturin Këshill Politik, që të mundësojë bashkimin në një Plan veprimi të krejt atyre që quhen “liderë shqiptarë”.

Parti, dmth pjesë, copëza, pra le ta lënë krenarinë e tyre të pjesshme dhe të ulin kokën nën flamurin kombëtar. Le t' i mbyllin në një dhomë, e të mos dalin pa pranuar vënien e drynit tek partiçkat e tyre. Për ta kuptuar se kjo është gabuar mjafton të shohim në histori sesa janë investuar armiqtë tanë në përçarjen tonë. Dikur në taborre, fise, liderë, dhe sot në parti.

JUSUF BUXHOVI

RUGOVA, MIDIS MITIT DHE MOHIMIT

(Mos)kuptimi i misionit historik të LDK-së në procesin e shtetndërtimit si dhe i rolit të Ibrahim Rugovës në të, siç po shfaqet në fushatën zgjedhore nga ai i ikonës partiake në anë të ndryshme e deri te mohimi i tij kuturu nëpër studio televizive nga disa opinionistë ikonoklastë, dëmton pikërisht kauzën mbi të cilën është ndërtuar Lëvizja kombëtare misioni i së cilës historikisht ka përfunduar më 12 qershor 1999.

Ditëve të fundit, fushata zgjedhore, tematizoi Lidhjen Demokratike të Kosovës si dhe dr. Ibrahim Rugovën në të mbi premisat e (mos)kuptimit ose të (keq)kuptimit tek mitizimi i tij, apo mohimi antihistorik i rolit të tij në themelimin e kësaj partie dhe të shtetit të Kosovës, ku ai ka vend merit.

Ky tematizim bëhet në njërin anë duke u ngatërruar marrja e drejtimit të partisë nga ana e Rugovës në Kuvendin Themelues, që me të shpejtë do të kthehet në Lëvizje kombëtare - tek atributet e "themeluesit të vetëm" të partisë, që shfaqet si slogan në çfarëdo promovimi partiak vend e pa vend (veçmas këto ditë nga liderë të saj militantë), gjë që gjithë projektin politik të disa brezave dhe veçmas të atyre që koha ua ngarkoi përgjegjësinë të merreshin me të - të tillë ishin thujse e gjithë shtresa intelektuale e Kosovës e të gjitha niveleve që u kyçën në të - e zhvlerëson nga meritat historike të tyre për ta bartur te kulturi i individit.

Me këtë rast nocioni "Rugovizëm", të shumtën me gjuhën e eseve letrare dhe apologjizma, ngrihet jashtë ndonjë doktrinariteti të mbështetur në vepra, që atë do ta kthenin në ideologji, siç ndodh me marksizmin - me veprat e Marksit, stalinizmin me veprat e Stalinit, enverizmin me veprat e Enverit, titizmin me veprat e Titos e të tjera. Meqë Rugova nuk ishte politolog dhe pa asnjë shkrim në këtë fushë, ishte programi i LDK-së mbi të cilin u ndërtua Lëvizja Kombëtare, që ai e pranoi pa ia shtuar asnjë pikë e presje, ku ai mbeti dhe nuk lëvizti fare deri në fund. Ky program, pra është platformë dogmatike, që mbështetet mbi ideologjinë kombëtare analoge me atë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që filloi me kërkesën për barazi (autonomi në një vilajet të përbashkët) brenda përbrenda Perandorisë Osmane, për të përfunduar, në Shkup, në gusht të vitit 1912, me 14 pikëshin e Hasan Prishtinës, që si Shqipëri Osmane do ta vërë në binarë historikë pavarësinë e Shqipërisë të shpallur më 28 Nëntor 1912.

Pra nëse mund të flasim për ndonjë "dogmë rugoviste", atëherë kjo duhet të lidhet me Programin e LDK dhe konceptin e ndërtimit të shtetit mbi platformën e tij. Të tjerat janë pjesë e apologjisë politike për konsum partiak, që nuk i shkon rrethanave të



kohës, e aq më shumë i shërbejnë ndryshimit për të mirë të gjendjes që pritet nga këto rrethana të kthesave të domosdoshme shoqërore dhe politike në kuadër të një ndryshimi demokratik, ku LDK-ja duhet të ketë rol aktiv me programe për ardhmërinë e shtetit dhe të mirëqenies së tij dhe assesit të "mësuesit të historisë"!

Tematizimi në tjetër anë i figurës së Rugovës dhe rolit të tij në këtë proces tashmë të kryer historik që e prodhoi shtetin me qëllim të minimizimit ose mohimit e tij, me fjalë boshe dhe fyërje të natyrës ikonoklaste nëpër studio televizive nga opinionistë gjoja të pavarur por në në vërtetë militantë të maskuar të drejtuar nga partitë politike, lidhet me atë të liderit ndër më të sukseshmit në skenën politike shqiptare të këtij shekulli që promovoi kulturën intelektuale, vizionin politik si dhe patriotizmin shtetëror. Ishin këto premisa mbi të cilat ai u ngrit dhe për tetë vite drejtoi lëvizjen institucionale me shtetin paralel në rrethanat e okupimit policor dhe ushtarak serb. Ai këtë rol e ushtroi si president i parë historik, i zgjedhur me votën e qytetarëve në vitin 1992, në vitin 1998 dhe i rizgjedhur edhe në vitin 2001 dhe 2004. Natyrisht se mohuesit e Rugovës e me të edhe të historisë së shtetit të Kosovës, në konotacion negativ, përdorin nocionet "rezistencë paqësore", "gandizëm", "nënshtrim në shërbim të pushtimit" e të tjera, ku nuk mungon edhe atributi "i tradhëtarit" dhe i "tradhëtisë", që prodhoi pasoja të njohura tragjike të cilat edhe sot e gjithëditën vazhdojnë të jenë përçarëse.

Natyrisht se diskursi i parë - mitizimi për nevoja politike dhe, i dyti - mohimi kuturu i një procesi historik dhe i rolit të partisë së parë pluraliste

shqiptare (LDK-së) në rrethanat pas rënies së Murit të Berlinit dhe fillimeve të rënies së bipolaritetit blokist, dhe të dr. Ibrahim Rugovës në të, ka të bëjë me prirjen që koncepti "i çlirimit" si doktrinë ideologjike-revolucionare të fitojë primatin historik ndaj konceptit të rezistencës institucionale-paqësore gjoja "joefikase" madje "kapituluese" institucionale e me të edhe të marrjes së pushtetit me dhunë, ose të segmenteve të tij kryesore, siç ndodhi gjatë protektoratit ndërkombëtar, që i hapën rrugë edhe kapjes së shtetit nga grupet kriminale të vendosura edhe në skenën politike, që sollën gjendjen e rëndë në të cilën ndodhet sot shteti i Kosovës.

Këtij përcaktimi, si po shihet, për të fituar pushtet dhe hapësirë mediale deri në nivel të propagandës së hapur, i ka ndihmuar mosnjohja e rrethanave kruciale nëpër të cilat kaloi LDK-ja si dhe lëvizja që e drejtoi ajo nga vetë liderët e tanishëm të kësaj partie, ku ajo e kauzës fillestare të programit të kësaj partie e ngritur mbi konceptin e kërkesave për liri, demokraci dhe barazi, e aprovuar në Kuvendin e saj Themelues më 23 Dhjetor 1989 shfaqet e turbullt dhe me deficite elementare të njohjes! Natyrisht kjo ka bërë që të krijohet njëfarë mjegullimi rreth procesit të evolucionit të shpejtë politik në përputhje me zhvillimet siç ishin ato të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik e me këtë edhe të fillimit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë pas agresionit të Armatës Jugosllave në Slloveni në maj të vitit 1991. Konferenca e Hagës e gushtit të atij viti, ku edhe u mor vendimi për shpërbërjen e Federatës jugosllave mbi bazat e të drejtës së vetëvendosjeje së njëjës federative, ishte referenca kryesore e ndryshimit konceptual ndaj çështjes që u përcoll me veprimet e duhura

politike mbi të cilat u vendos procesi i pavarësisë, që si i tillë, si ata juridik dhe politik, do t'i shërbejë edhe GJND-së së Hagës për ta shpallur pavarësinë e Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Kjo bëri që edhe LDK-ja, në marrëveshje me subjektet e tjera pluraliste në hapësirat e ish-Jugosllavisë, kërkesën e deriatëhershme për BARAZI në federatën jugosllave, ta riformulojë në kërkesën për PAVARËSI.

Ndryshimi i kërkesës së mirëfilltë nga jo për BARAZI (krahas atyre për liri dhe demokraci, pra për sistem pluralist me të cilin rrënohej monopoli i partisë komuniste në pushtet dhe i komunizmit si sistem), siç theksohej në programin e aprovuar ditën e themelimit të partisë, pra më 23 Dhjetor 1989, në PAVARËSI, që do të aprovohej në Kuvendin e Parë të rregullt LDK-së më 5 Maj 1991, ishte në përputhje me ndryshimet radikale të kohës, të cilave u duhej përshtatur me të shpejtë me vendime dhe veprime konkrete politike dhe diplomatike, siç ishte edhe kërkesa Komisionit të Badinterit në vitin 1992, që Kosovës t'i njëhej e drejta e njohjes ngaqë në Kuvendin e Kaçanikut më 7 Shtator 1990 kishte shpallur pavarësinë si njësi e pavarur federative.

Parja e Programit të LDK-së nga Kuvendi themelues pa këto ndryshime qenësore dhe vendimet dhe dokumentet me të cilat ato u legjitimuan, është veprim i njëanshëm dhe jashtë kontekstit të misionit historik, gjë që i shkëputur edhe mund të manipulohet me të madhe siç ndodhi duke iu amputuar shumë të pavërteta dhe se siç po ndodh kur duhet t'i ndajmbat-hën edhe "mëkate" të tjera!

Por, për t'u kuptuar sa më mirë ky

ndryshim, pra kthimi i kërkesës së mirëfilltë BARAZI (ku kritikuesit e saj të sotëm joparimore po mundohen ta lidhin me "jugosllavizmin" e të ngjashme në rrethanat kur ai po binte), të kërkesa për PAVARËSI, mbi të cilën do të mbështetet i gjithë procesi i lëvizjes institucionale-paqësore me shtetin paralel nga viti 1992 e deri më 12 Qershor 1999, është e domosdoshme njohja e atyre që quhen parakushte të këtij ndryshimi historik. E këto janë:

- Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990;

- Kuvendi i Kaçanikut i 7 Shtatorit 1990 kur Kosova u shpall Republikë e pavarur në kuadër të federatës Jugosllave si dhe

- Referendumi për Pavarësi të 26 Shtatorit 1991.

Këto tri ngjarje që rumbullakuan infrastrukurën e legjitimitetit demokratik, kanë pasur për bazë vendimin e Partive Politike Shqiptare në ish-Jugosllavi (dhjetë sosh natyrisht të prira nga LDK-ja si strumbullar i tyre), nga gushti i vitit 1990 rreth tri opsioneve.

I pari opsion kishte të bënte me Republikën e Kosovës në Federatën jugosllave, po qe se ajo do ta ruante karakterin e njëjtë që kishte.

Opsioni i Dytë kishte të bënte me formimin e një Republike shqiptare në Jugosllavi, ku do të përfshiheshin të gjithë shqiptarët e shpërndarë në tri republika, po qe se do të ndryshonte karakteri i saj i brendshëm (federal-konfederal)

Dhe opsioni i tretë - lidhej me vendimin se po të shpërbëhej Federata jugosllave, atëherë shqiptarët vendosnin pavarësisht për fatin e tyre duke mos u përjashtuar bashkimi me Shqipërinë.

Këto (mos)kuptime sado triviale që shfaqen sot - sa nga mosnjohja e vetë liderëve të tanishëm të LDK-së dhe sa nga (keq)kuptimet e kursit të LDK-së dhe rolit të saj historik nga mohuesit e saj nga kundërshtarët e saj ideologjikë, nuk mund ta rrënojnë pamjen historike të lëvizjes institucionale, me shtetin paralel, që u ndërtua mbi obligimet kushtetuese nga Kuvendi i Kaçanikut, mbi të cilat u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale në vitin 1992 dhe ato të vitit 1998, në rrethanat e luftës.

Por, edhe përkundër kësaj të vërtete, po shihet se disa nga liderët e sotëm të LDK-së, nuk e njohin mirë këtë pjesë të historisë së partisë e as të lëvizjes shtetndërtuese, ose dëshirojnë që atë ta përdorin pjesërisht për qëllime të caktuara, ku duhet të shihet vetëm roli mitizues i Rugovës në të,

me ç'rast përjashtohen faktorët tjerë të gjithëmbarsëm që e kanë bërë lëvizjen dhe e kanë bartur atë deri te qëllimi historik, veçmas faktori ndërkombëtar si dhe mbikëqyrja prej tij në të gjitha fazat - të "politikës pa luftë", pra të shtetit paralel dhe të "luftës pa politikë", pra të rezistencës së armatosur.

Në këtë diskurs moskuptues të historisë së partisë "mëmë" nga disa liderë të saj, prej nga ata prej vitësh përfitojnë si shumë pa qenë në gjendje t'ia mbrojnë themelet, por edhe mohues nga zhvlerësues të saj me "argumente" të interesave grupore për pushtet ose aso ideologjike, shpatat më së shumti thyhen tek çështja e rezistencës së armatosur si dhe zanafilla e saj nga organizimi vendor i këshillave të mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes e pasqyruar me organizimet e para që ka filluar LDK nga mesi i vitit 1990, dërgimit të disa grupeve vullnetare për stërvitje në Shqipëri në përputhje me marrëveshjen midis Rugovës dhe Ramiz Alisë dhe atë një vit më vonë me presidentin Berisha, e deri te obligimi kushtetues, në kuadër të Qeverisë së Përkohshme të themeluar në fillim të vitit 1992, kur ajo krahas ministrive të tjera kishte edhe Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Rendit (pra të policisë).

I gjithë ky aktivitet, pra ka qenë fillimisht në kuadër të strukturave të

LDK-së dhe më vonë të Qeverisë së Kosovës, paçka se është përcjellë me vështirësi, gabime dhe lëshime të shumta madje edhe me pasoja.

Ka rëndësi me këtë rast të thuhet se veprimtaria e dy ministrive të Qeverisë së Kosovës (asaj të mbrojtjes në formën e organizimit të mbrojtjes territoriale me në krye gjeneralin Hajzeri), kanë vepruar deri në fund të vitit 1993, kur edhe do të burgosen nga regjimi jugosllav, por që kjo veprimtari, bashkë me atë të grupeve guerile (Drenicë dhe Dukagjin), është dashur të ndërpritet në Janar të vitit 1993, pas Kërcënimit të Kërshëndellave të 24 Dhjetorit të Presidentit amerikan Xhorxh Bush, dërguar Millosheviqit, që njihet si "vijë e kuqe" që të mos përdor luftën në Kosovë. Ky kërcënim u është drejtuar edhe shqiptarëve që të mos përdorin kurrfarë aktiviteti luftarak.

Pra, LDK dhe Qeveria e Kosovës kanë qenë të detyruara t'u rrinë larg grupeve guerile dhe të "ngrijnë" punën e dy ministrive (të Mbrojtjes dhe të Policisë). Meqë SHBA-të dhe NATO kanë qenë ata që kanë kërkuar "politikë pa luftë", së cilës dr. Rugova i është përmbajtur me përpikëri, siç kanë kërkuar që edhe të mbahen zgjedhjet në Qershor të vitit 1998, me ç'rast kjo kërkesë i është drejtuar personalisht dr. Rugovës në Uashington nga Klintoni dhe në Gjermani, gjatë

pritjes që ia ka bërë kancelari Kohl.

Mbajtja e këtyre zgjedhjeve është kërkuar nga SHBA-ja dhe vendet e NATO-s për mbajtjen e hapur të dy linjave (institucionale dhe të rezistencës së armatosur gjithnjë të mbikëqyruar nga jashtë), për qëllime të caktuara, që si do të shihet më vonë, do t'i shërbejnë ndërhyrjes së armatosur qoftë me pretekste humanitare, meqë Beogradi, ndaj sjelljes institucionale dhe demokratike të shqiptarëve kundërpërgjigje me dhunë shtetërore, që ishte e natyrshme që në rrethana të caktuara të prodhojë edhe rezistencën e armatosur.

Ato që kanë ndodhur në Tiranë dhe në relacionet Kosovë-Shqipëri nga viti 1997 kur do të dalë në skenë UÇK-ja, si dhe rikthimi i Ministrisë së Mbrojtjes nga Qeveria e Kosovës në pranverën e viti 1998 me në krye ministrin e FARK-ut Ahmet Krasniqin, pastaj marrëveshjen e Oslos për luftë të për-bashkët, ku FARK-u subordinohej në UÇK, nuk mund të kuptohen drejt pa rolin e faktorit ndërkombëtar në to dhe veçmas përcaktimet që rezistenca e armatosur të mbahet e mbikëqyruar (në nivelin e grupeve të shkëputura) dhe jashtë drejtimi intitucional. Pra, ato që do të ndodhin brenda limiteve ndërkombëtare të vendosura nga SHBA-të dhe NATO-ja rreth mbikëqyrjes së rezistencës së armatosur në të gjitha fazat, qoftë edhe kur

cilësohej "si terroriste", nga brenda paraqesin kapitullin tragjik të një gare për drejtimin e asaj që lejohej midis Qeverisë së Kosovës dhe LPK-së.

Kjo e dyta, kur në vitin 1993, do të largohet nga Lëvizja Kombëtare që drejtonte LDK-ja, ku ishte futur me kërkesën e saj si anëtare kolektive, do të plotësojë vakumin që la pas pasivizimi i Ministrisë së Mbrojtjes nën diktatin amerikan dhe ndërkombëtar por edhe disa mosmarrëveshjeve të brendshme rreth kësaj çështje.

LPK-ja me ideologji majtistë, e drejtuar nga dy grupe jashtë (Gjermania dhe Zvicra), e lidhur me qeverinë socialiste të Tiranës dhe me koncepte të njohura ideologjike, me këto veprime, duke u sjellë në hapësirën e rezistencës vendore dhe të resurseve të saj patriotike, megjithatë mbajti "të ndezur" fitilin e rezistencës së armatosur, që do të vihet në veprim pas marrëveshjeve të Dejtonit, me çka u ndihmua që lufta diplomatike të kthehet në diplomaci të luftës, siç ndodhi pas Rambujesë.

Ky digresion i shkurtër nëpër histori, që trajtohet dhe argumentohet në veprën "Kthesa historike" I si dhe "Kosova" V, VI dhe VII, pa pretenduar se çështjes i është vënë pika, meqë shkenca nuk pranon kornizat dogmatike e aq më pak përvetësimet nga pozicioni i "fitimtarit" dhe "të fortit",

ka për qëllim që të tërheqë vërejtjen mbi keqpërdorimet e personave historikë, siç është i dr. Ibrahim Rugovës me këtë rast për qëllime zgjedhore deri te shkalla e manipulimeve të paskrupullta mbi bazat e "pronësisë partiake", që i tejkalon ato edhe për vetë faktin se ai ishte drejtues i një lëvizjeje kombëtare gjithëpopullore në të cilën morën pjesë të gjitha rrymat dhe shtresat shoqërore dhe politike që kërkonin çlirim nga Serbia dhe liri, demokraci dhe pavarësi.

Pra, përdoruesit si dhe shpërdoruesit e historisë, duhet ta kenë të qartë se vlerësimet dhe rivlerësimet historike të ngjarjeve si dhe personaliteteve në to, nuk kalojnë nëpër filtrat politikë, siç janë të tanishmit ku partitë pretendojnë monopole edhe ndaj figurave historike që i tejkalojnë kornizat e tyre, por kalojnë nëpër ato shkençorë, ku distanca kohore dhe dokumentet kanë fjalën kryesore.

Në këtë aspekt, nderimi i dr Ibrahim Rugova, nga kundërshtarët e tij të deridjeshëm, ia konfirmon meritat e tij historike, por rikthen edhe nderimin e institucionit shtetëror që ai e përfaqësoi me legjitimitet të plotë. Presidentin historik të Kosovës, megjithatë, nuk e nderojnë as ikonofilia e as ikonoklastia për qëllime të fushatave politike, meqë janë pjesë e nekrofilisë...

TRANSPORT JETI LTD


Korrektesi & Shpejtesesi




ANGLI - SHQIPERI

SHQIPERI - ANGLI

  **TRANSPORT JETI LTD**

 **ALB: +355 69 5161042**
+355685104344

 **UK: 07735553992 / 07848690910**



OFERTA SPECIALE PËR PESHA TË MËDHA

DR. GINO LUKA

SHQIPTARËT NË HUNGARI: KLEMENTINASIT QË JETONIN PËRGJATË RRJEDHËS SË LUMIT SAVA

Në territorin e Hungarisë, veçanërisht në pjesën jugore të Szerémség, dikur Mbretëria e Hungarisë, sot teritorit të Kroacisë e të Serbisë (Vojvodina), përgjatë rrjedhës së poshtme të lumit Sava (Száva), ka jetuar një komunitet me shqiptarë. Sipas burimeve historike, pas pushtimit turk të shek. XV grupi etnik i quajtur Klementinas u vendos kryesisht në dy fshatra: në Herkócán (Hrtekovci) e Nyéken (Nikinci). Më poshtë le të shohim këtë kuriozitet etnografik, historinë e të vetmit “ishull” të banuar nga shqiptarët në Hungari!

Në provincën, ose “Komitetin” e Szerém-it, në Hungarinë jugore, deri gjatë periudhës përpara Luftës së parë botërore, kanë vazhduar të ekzistojnë këto dy fshatra: Hrtekovce dhe Nikinci.

(Komitetet e Mbretërisë së Hungarisë, në hungarisht vármegye, kanë qenë ndarjet kryesore administrative të mbretërisë për shumë shekuj. Pas reformës së fundit administrative të vitit 1867 ato ishin 71, nga të cilat tetë i përkisnin Mbretërisë së Kroaci-Sllavonisë.)

Sikur të kishim shkuar në këto vende, rreth vitit 1850, do të ishim befasuar sepse do ta kishim ndjerë veten papritmas diku tjetër: në vende të banuara nga një fis me zakone të ndryshme nga ata të vendit dhe që flet një gjuhë tjetër.


Në këto dy fshatra jetonte një popullsi e begatë shqiptare, me prejardhje barinjsh luftëtarë. Më vonë u dalluan si bujq dhe blegtorë të zotë. Ndërmjet tyre kishte edhe vreshtarë që ishin të njohur për prodhimin e një vere të mirë, Salaksia.

Vera Salaksia, e vjetërsuar dhe me shije të thatë nuk kishte dallim, për cilësinë e saj të jashtëzakonshme, nga verërat e Malagës. (List mësečni horvatsko-slavonskoga Gospodarskoga Društva, 1847, Zagreb. Gazetë mujore e Shoqërisë Ekonomike Kroate-Sllavone Fq. 87)

Ndërsa sipas agronomit të njohur hungarez Ferenc Schams (l. 1780 – v. 1839) Karlóca ka qenë rajoni i dytë pas Tokaj-it, në 14 rajonet historike të prodhimit të verës. Këtu prodhohej vera aszú (me vile rrushi të thara të goditura nga myku botrytis cinerea), nga varieteti i rrushit Kadarka me prejardhje nga Shkodra. Në kohën e pushtimit turk vreshtat dhe prodhimi i verës u dëmtua seriozisht.

Edhe delet e tyre, që kishin marrë nga Shqipëria, kanë qenë të famshme në të gjithë Sllavinë e qoheshin klementinase, pikërisht sipas emrit të klementinasve.

Emri Klementinas mund të jetë edhe një titull për historinë e tyre tragjike që patën këta emigrantë shqiptarë. Mendohet se një kapedan i ushtrisë së heroit shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i quajtur Klement, në kohën e pushtimit të Sulltan Muradit II, aty nga gjysma e shekullit XV, në



krye të dy mijë shqiptarëve, emigroi nga vendlindja e tij, duke shkuar për të themeluar një shtet të vogël të pavarur midis maleve të kufirit serbo-hungarez. Në lidhje me emrin Kelmend, Albanologu Zef (Giuseppe) Valentini, flet për fisin e Kelmendit, të cilin në dokumente e gjejmë qysh në vitin 1242. Ndërsa si mbiemër i dokumentuar është gjetur në vitin 1353, Gjergji, i biri Gjergj Kelmendit nga Spasa (vend), (dominus Georgius fulius Georgii Clementi de Spasso). Në fjalorin gjeografik të botuar nga Elek Fényes në vitin 1840, përcaktohet numri i “klemetasve” në 1600 shpirtra, të cilët në atë kohë jetonin të gjithë në dy fshatra, në Szerém.

Sipas Palóczy Edgár një variant tjetër i emrit Kelmend, sipas traditës së këtij grupi etnik katolik, është ai i një bariu me emrin Klement, i cili ishte themeluesi i fisit të madh të kelmendasve. Këtij i lindën shtatë djem, secili prej tyre themeloi nga një klan – ndërmjet tyre gjejmë, për shembull, fisin Martinovics. Ky emër tingëllon i njohur; Ignác Martinovics e mori emrin nga i ati dhe është një pasardhës i largët i këtij klani. Ky murg

franceskan, që predikoi doktrinat e Jakobinëve hungarez, nuk jetoi kurrë në këtë zonë, ai lindi në Pest në vitin 1755, por babai i tij ka qenë sigurisht nga Shqipëria e sotme.

Klement, klementinas a kelmendas, mendohet se emri këtij fisi vjen nga fjala latine clemens-(tis), d.m.th. i mëshirshëm, e më vonë e gjejmë si emër personi Clemens. Në shkrimet e studiuesve të huaj emri gjendet i transkriptuar në “Klemnti, Klimenti, Clementiner” etj. kurse në gjuhën shqipe “Kelmen, Klemente, Kelmendi”. Për herë të parë, në kuptimin e sotëm, e ndeshim te Papa Klementi i I-rë (90-101 pas.K.) dhe Shenjt i Kishës Katolike. Kelmendasit e kanë adhuruar si mbrojtës të fisit në tërë historinë e tyre duke ia kushtuar lutjet dhe kishat e tyre këtij shenjt.

Pra, fillimisht kryeqendra e vogël e këtij ngulimi mori emrin Klement, e më pas e gjithë kolonia. Më vonë, megjithatë, për të ruajtur lirinë e tyre klementinasit u detyruan nga Porta e Lartë, të paguanin një haraç prej 4,000 fiorin në vit.

Gjatë tridhjetë viteve të para të

shekullit të 18-të klementinasit ishin nën mbrojtjen e Mbretit Karli i III, i cili pati një ndikim shumë të fortë në Ballkan, kështu që kolonia lulëzoi dhe jetoi e qetë e pa shqetësime.

Fillimisht klementinasit emigruan në disa male të shkreta në kufi me Serbinë, për të shpëtuar nga persekutimet e turqve. Disa vjet më vonë peshkopi Arsenije IV Jovanović Šakabenta, në vitin 1737, i bindi ata të braktisnin ato male të pafrytshme për të shkuar dhe jetuar në territorin serb. Në fakt, ishin njëzet mijë shqiptarë dhe serbë që po përgatiteshin të shkonin në Vailovánál (Vallicovo)kur turqit, pasi fati i luftës ishte kthyer kundër gjermanëve, u sulën mbi emigrantët, duke bërë një masakër të tmerrshme.

Mjafton të themi se nga njëzetmijë që ishin, vetëm njëmijë mbijetuan, ndërmjet të cilëve vetëm treqind shqiptarë klementinas.

Ndërsa ikin, të shkretët, të përndjekur nga hakmarrja mizore turke, kapërcyen lumin Sava dhe Mbreti Karli II u dha mundësinë për t'u vendosur në territorin e mbretërisë së tij, ku themeluan dy fshatrat Hrtekovce

dhe Nikinci.

Në ato toka, klementinasit e shkathët krijuan mirëqenie dhe jetuan të qetë, në këtë mënyrë ata u stabilizuan duke ruajtur edhe zakonet e traditat e tyre.

Për më shumë se njëqind vjet ata mbetën pa u përzier, si grup etnik, në gjuhë dhe zakone, edhe pse me bashkatdhetarët e tyre i ndante feja, meqë serbët ishin ortodoksë.

Kështu, gjithnjë duke u martuar me njëri-tjetrin, për një kohë të gjatë, nuk pati depërtime të etnive të tjera; pra trashëgimia morale, tradicionale dhe gjuhësore e stërgjyshërve nuk u prek.

Gjatë pesëdhjetë viteve të para të 1800-ës, ata mbetën shqiptarë, dhe ka shumë udhëtarë dhe shkencëtarë, veçanërisht hungarezë, të cilët përshkruajnë jetën dhe zakonet e këtij populli të çuditshëm që kishte hyrë në zemër të Hungarisë pa u asimiluar, gjatë shumë brezave.

Por kur Maria Teresa themeloi një urdhër special të tipit ushtarak (në gjermanisht Militär-Maria-Theresien-Orden), që përfshinte të gjithë banorët e zonave kufitare, interesi kryesor u drejtua nga shqiptarët hungarez. Në atë kohë, meqë ishin luftëtarë të zotë, ata ishin të organizuar në reparte ushtarake për ruajtjen e kufirit, e pikërisht në atë kohë fillon edhe zvetërimi i tyre.

Një shkencëtar hungarez, Danielis Cornides, i vizitoi në vitin 1777 për të studiuar zakonet dhe doket e tyre, dhe shqyrtoi tërësisht çdo detaj, që më pas e përshkroi. Ai gjeti të gjitha zakonet dhe traditat më të lashta dhe që i pranishëm gjatë valleve tradicionale shqiptare.

Ai përshkruan një nga këto valle që organizohej përjashta në natyrë: gratë dhe burrat, me kostumet e tyre shqiptare, vendoseshin në dy rreshta, secili duke mbështetur krahun e majtë në shpatullën e tjetrit dhe duke kënduar dhe kërcyer, sipas ritmit, këngët e lashta të Shqipërisë, të trashëguara brez pas brezi nga baballarët, në mënyrë misterioze.

Ndërmjet dy rreshtave dilnin duke kërcyer dy burra me shpata në dorë, dhe kërcenin duke luajtur dhe duke rrotulluar armën, me një ritëm të egër. Gratë pastaj ngrinin me duart lart një shall mëndafshi, gjithmonë duke qëndruar në një vend në mes të lëvizjeve të mrekullueshme, duke iu drejtuar herë një kërcimtari e herë një kërcimtari tjetër. Në fund, në vend të muzikës, kumbonte vetëm kënga e vajzave, duke himnizuar lavdinë e heronjve të vjetër, veçanërisht të Skënderbeut.

Zakonet e tyre janë ende të vrazhda, nganjëherë zemërohen papritmas të shtyrë nga mendimi i hakmarrjes, por vëzhguesi i kujdesshëm vëren se janë të ndershëm, besnikë e të rezervuar. Ata martohen të rinj. Burrat 20 vjeç

dhe gratë 13-14 vjeç. Janë shtatllartë me tipare të rregullta dhe të këndshme. Gratë në moshë të re dallohen për bukuri e burrat e tyre janë krenarë dhe xhelozë deri në ekstrem. Studiuesi Danielis Cornides rekomandon që askush të mos flasë me gratë pa krijuar miqësi më përpara, sepse nga burrat e tyre mund të pritët çdo gjë...

Personat e një familjeje zakonisht jetojnë së bashku në një shtëpi, kështu që formohen familje me 30-40 anëtarë. Të dy fshatrat janë të ndërtuar mirë; kishat janë të ritit romak, pasi ata janë katolikë deri në pikën e fundit. Shtëpitë e tyre janë të mëdha dhe të pastra.

Ushqimet i kanë me cilësi më të mirë se të serbëve, djathërat janë ushqimi kryesor. Pija e tyre e preferuar është rakia të cilën e përziejnë me mjaltë. Edhe grave u pëlqen të pinë.

Edhe Elek Fënyes, në vitin 1842, shumë vite më vonë, përshkruan imtësisht zakonet dhe traditat tipike shqiptare të banorëve të dy fshatrave: Veshja e tyre është e veçantë, ngjyra e kuqe luan një rol të rëndësishëm. Burri mban një kapelë të kuqe, një xhakëtë të shkurtër e të ngjeshur pas trupit, prej një stofi të trashë, të zbukuruar me peliçe të zezë dhe gajtana, një gete shumëngjyrëshe dhe çorape të kthyer me pala, një shall të zi (si kravatë) dhe një përparëse me ngjyrë të kuqe të errët mbi të cilën gjendet një përparëse tjetër me ngjyrë më të qartë e zbukuruar me thekë. Burri e shtrëngon belin me një brez stofi, në të cilin mban një kobure dhe një thikë. Shpata i varet anash, ndërsa topuzin prej bronzi ose hekuri me një bisht prej gjysmë metri të gjatë e mban në dorën e djathtë.

Gratë, flokët e bukur të zinj i kanë të mbledhur në një gungalec, të mbështetur mbi shpatulla, përpara; në pjesën e pasme, të kapur mbi kokë, kanë një vello mëndafshi të zbukuruar me shirita. Qafa është e rrethuar me zbukurime që shndrisin. Përveç këmishës së gjatë, e cila u ndalon hapat e mëdhenj, ata veshin një jelek me bordura të zbukuruar me para, dhe përparësja shumëngjyrëshe varet nga rripi i larmë me një tokëz me zinxhir bakri. Veshja e sipërme përbëhet nga një veshje e kuqe me peliçe, thekë dhe qepje, mëngët e të cilës arrijnë vetëm deri në bërryla. Çorapet e tyre të larmishme janë të ngjashme me ato të burrave.

Mund të thuhet se asimilimi i tyre i vërtetë ose më mirë "kroatizimi" fillon pas viteve 1850, dhe më shumë se gjithçka tjetër për "faj" të shkollave, ku të rinjtë, duke mësuar të flasin një gjuhë të re, harruan të tyren.

Dhe dihet që gjuha është themeli mbi të cilin mbështetet ndërtesa e një grupi etnik, që është e përbërë nga shumë e shumë gjëra, duke filluar nga veshjet e deri të muzika, nga ushqimi të besëtytnitë, por më shumë se gjithçka tjetër nga vetë grupi shoqëror, që ka prirje për t'u shpërndarë e për t'u shkrirë.

Në fillim të shekullit XX, vetëm të moshuarit, tashmë, flisin gjuhën shqipe, ose ndoshta vetëm e kuptonin. Shumë interesa tani i lidhnin banorët e atyre tokave me njëri-tjetrin, të cilët "ndotnin" njëri-tjetrin, duke harruar,

për shkak të një force që nuk mund të mposhtet, trashëgiminë historike me prejardhje të drejtpërdrejtë nga Kastrioti, të cilën mbase e kishin ruajtur në mënyrë të pavetëdijshme deri atëherë. "Pesti Hirlap" i Budapestit gjithashtu shkruan për historinë e tyre, dhe thotë ndër të tjera se mbishkrimet e varreve

banologjisë të cilat janë në zhvillim e sipër.

Traktatet e fuqive të mëdha nuk e morën parasysh ekzistencën e këtij komuniteti dhe, duke gjymtuar tokën hungareze, ata përfshinë në territoret serbe edhe dy fshatrat e atyre shqiptarëve që në kohërat antike, për të sh-

Italisht dhe shqip (tekst dygjuhësh me ushtrime dhe lojëra gjuhësore).

Me librin "Fabula Shqiptare", (Ed. Nuovi Autori, Milano 1998) ka fituar Çmimin e dytë Letrar Ndërkombëtar "Tito Casini", të shpallur nga Universiteti Katolik i Milanos në vitin 1999.

bánok a Szerémségben, (Shqiptarët në Szerémség) Aracs: gazeta e hungarezëve të Jugut, 2018. – Világ-Krónika (Kronika nga bota) IV, 1880. N. 27, 210.

- Ignác Martinovics
- Ignác Romsics, Historian, Member of the Hungarian



të mbledhura në varrezat antike të dy vendeve klementinase dëshmojnë mjaft mirë për besnikërinë dhe dashurinë që popujt e jugut të Hungarisë së Madhe ruanin për mëmëdheun e tyre. Kur László Réthy studiues i famshëm i numizmatikës, bëri një vizitë në vitin 1895, vetëm disa të moshuar flisnin akoma gjuhën antike. Réthy ka qenë ndër studiozët e parë që ka parë librin e dorëshkruar të priftit të ndërës Antal Vozsenilek në kishën e Hrtkovce, me titullin "Sermones Albanici dicti per Antonium Voxenileg Parochum Hrtkovcensem".

Dalëngadalë fjala e fundit shqipe pothuaj është fikur në ngulimet shqiptare në Hungari, por Cornides e Réthy kanë qenë të kujdesshëm për të mos i humbur gjurmët e gjuhës shqipe. Të dy kanë mbledhur një fjalor dhe kanë transkriptuar besnikërisht lutjen Aty ynë në shqip, ashtu siç u a kanë thënë shqiptarët në atë kohë. Këto monumente të shqiptarëve hungarez nga viti 1777 e deri në vitin 1895 janë variante interesante e do t'i shërbejnë medoemos shkencave të al-

pëtuar nga zgjedha turke, kishin zgjedhur me vullnetin e tyre të ishin nënshtrësi hungarezë. Por ata shtetarë që ndanë tokat në atlasin gjeografik, ashtu si fëmijët që lozin me njëri-tjetrin, nuk kishin asnjë dijeni, ose qenë indiferentë, që në tokën e bukur hungareze kishte ende pakica shqiptare besnike ndaj vëllezërve të tyre hungarezë. /albanianews.it/ Mbi autorin: Dr. Gino LUKA, ka lindur në Shkodër ku ka kaluar një pjesë të jetës së tij. Aktualisht jeton në Firence. Është diplomuar në Universitetin e Firences në degën "Teoria dhe Praktika e Përkthimit", Fakulteti i letërsisë dhe filozofisë. Sot ai i është përkushtuar përkthimit dhe një pasioni tjetër: shkrimi.

Ndër veprat e tij mund të përmendim "Shënime të kuzhinës italo-shqiptare" (në gjuhën shqipe), një përmbledhje të anekdotave popullore të Nastradin Hoxhës", të përkthyer së fundmi në italisht. Në Itali gjithashtu ka botuar "Floçka: Fabula dhe përralla shqiptare" dhe "Nusja e ujërave". Bot.

Ndërmjet pasioneve të tij (sommelier) është edhe vera. Për "Albania News" dhe "Shqiptari i Italisë", përveç artikujve të tjerë me temë historike, ka shkruar në italisht historinë e verës në Shqipëri.

Ai rregullisht mban konferenca për folklorin dhe kulturën shqiptare.

Përkujdeset për blogun "Linguaculture" dhe ëndrra e tij është të jetojë në një botë pa luftëra.

Referime bibliografike:

- Báro Nopcsa Ferenc, Úti jegyzetek egy amatőr-etnográfus naplójából. Népélet (Ethnographia) XXXIV–XXXV. évf. (1923–1924) [1924!] 65–74. (Baron Ferenc Nopcsa, Shënime udhëtimi nga ditari të një etnografi amator. Etnografia XXXIV – XXXV. viti (1923–1924) [1924!] 65–74.
- Franco V. Dionisi – Le colonie clementiane, Le vie dell' 1928. Anno V – N. VII (Kolonitë klementinase, Rrugët e lindjes, 1928. Viti V. N. VII).
- Hetzmann Róbert, Al-

Academy of Sciences The treaty of Trianon and its repercussions (Traktati I Trianonit dhe ndikimet e tij), 2020.

- Palóczy Edgár, Albán telepek Magyarországon, Eredeti kiadás: Pesti Hirlap XXXVI. évf. 132. sz. (1914. jún. 7.) 65–66. (Ngulime shqiptare në Hungari), Botimi origjinal: Gazeta e Pestit viti XXXVI No. 132 (7 qershor 1914) 65–66.

- Szegh Dezsó, Az albánok. Katholikus Szemle évf. (1913) 7. sz. 787–800 (Shqiptarët. Revista katolike XXVII. viti (1913) Nr. 7. fq. 787–800).

- İskender Bey kimdir? – Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi. (Kush është Skënderbeu? – Enciklopedia e Fondacionit Fetar Islam të Turqisë).

- İSKENDER BEY Osmanlılar'a karşı mücadele eden Arnavut beyi. İslâm Ansiklopedisi (Fisniku që luftoi kundër otomanëve. Enciklopedia e Islamit).



Akoma nuk keni nje WEBSITE ?

Na kontaktoni

Adresa e Redaksise: 30 Avenons Road,
London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946 www.dotech.uk

**Studio Flat & 1.Bed Flat's
For Rent ,
At Hertford Road Enfield,
Close to Albany Swimming pool.
Contact: 07405455297**

Na gjeni ne facebook

thjesht kerko **The Albanian**

mbi **1000 000** ndjekes

**Ambasada e Republikës së Kosovës
në Mbretërinë e Bashkuar**
Embassy of the Republic of Kosovo

**8 John Street
London WC1N 2ES**
Email: embassy.uk@rks-gov.net
Tel: +44(0)207 405 1010

**Ambasada e Republikës së Shqipërisë
në Mbretërinë e Bashkuar**

Embassy of the Republic of Albania
33 St. George's Drive
London SW1V 4DG
Tel. +44 (0) 20 7828 8897
Fax +44 (0) 20 7828 8869
E-mail: embassy.london@mfa.gov.al
www.ambasadat.gov.al/united-kingdom/
To contact the Albanian Embassy
for emergency cases only

**please call:
07518662630**

(17.00-09:00 and during weekends)

MITI BRITANIK I KAPITENIT TOM DHE MANIA JONË PËR TË PËRBALTUR GJITHÇKA

ÇAPAJEV GJOKUTAJ

Pak ditë më parë mediat britanike njoftuan vdekjen nga Covidi të Sir Thomas Moore, 100 vjeç. Vetëm disa muaj para vdekjes, mbretëresha Elisabetë, në një audiencë personale, i dha titullin e kalorësit. Në fakt jeta e Moore, apo kapiteni Tom, siç njihet në Britani dhe më gjerë, veshitirë se pati gjë heroike. Vërtet ishte veteran i Luftës së Dytë Botërore, por rasti e kishte prurë të shërbente në Indi e në Burma kryesisht në stërvitje dhe trainim.

Për 99 vjet nuk ra në sy të medias dhe të opinionit publik. Bëri emër kur po mbushte shekullin dhe e arriti këtë me një veprim të rëndomtë, edhe ky larg heroizmit: 24 ditët e fundit para se të mbushte shekullin, u çapit në kopshtin e shtëpisë mbështetur në një stativ.

Kapiteni Tomi i konceptoi ecejakjet në kopsht si një fushatë për ngritje fondesh. Donte të mblidhte 1000 paund për llogari të Shërbimit Kombëtar të Shëndetit (NHS) dhe të shprehte kështu mirënjohje për mjekët që e kishin ndihmuar të perballonte një sëmundje të rëndë. Ditën që mbushi 100 vjet, kishte arritur të mblidhte 32 milionë paund, ndihmë jo e vogël për NHS në kulmin e valës së parë të pandemisë.

S'është vështirë të vësh re se kapiteni Tom u shfaq në publik jo aq si një individ konkret, sa si simbol i kuruar me mjeshteri, një lloj miti në kuptimin e gjerë të kësaj fjale. Në sendërtimin e tij u përfshinë një varg aktorësh si: media të shumta që i dhanë publicitet, këngëtari Michael Ball që regjistroi një këngë ku interpretonte dhe kapiteni, BBC Sport që i dha titullin "Personaliteti Sportiv i Vitit", ministria e Luftës që e gradoi kolonel nderi, një milionë e gjysëm qytetarë që mbështetën nismën, financiarisht, pesëqind mijë të tjerë që i dërguan kartolina ditën e përvjetorit të njëqindtë, Mbretëresha që e bëri kalorës etj.

Kur sheh gjithë këtë pjesëmarrje nis e pyet veten: a ia vlen të mobilizohen kaq shumë individë e institucione thjesht për të kthyer në mit një njeri të zakonshëm? Dhe më tej: a është e moralshme të bësh hero një njeri të zakonshëm që s'bën ndonjë heroizëm? Edhe milionat që mblodhi kapiteni Tom, do shtonin cinikët, janë fryt i mediatizimit të qëllimshëm dhe jo i çapitjes së një të moshuari në kopshtin e vet.

Gjithsesi milionat që mblodhi kjo nismë përbëjnë vetëm njerën anë të dobisë sociale, madje jo më të rëndësishmen. Shumë më e çmuar e më ndikuese ishte fryma që ngjalli procesi i krijimit të këtij miti.

Në kulmin e valës së parë të pandemisë qindra mijëra vetë u ndjenë të përfshirë në një nismë bamirësie, kurse miliona të tjerë u grishën të shpresonin se mirësia, bamirësia e



njerëzilleku do t'i ndihmonin, si individë e si bashkësi, që të përballnin të keqen.

2.

Kur sheh se si britanikët, aq të pasur me tradita e njerëz të shquar, pikasën një plak të zakonshëm dhe e kthyen në hero, nxitesh të meditosh marrëdhëniet që kemi ne me heronjtë dhe me mitet e reja. Ndryshe nga britanikët jemi popull i vogël e modest në tradita dhe rrjedhimisht nevojat për modele pozitive dhe heronj i kemi shumë më të forta. Kjo mungesë vjen e bëhet më vepruese edhe si pasojë e dy faktorëve të tjerë.

Prej dekadash sistemin e vlerave morale e kemi në krizë, rrjedhimisht modelet që nxisin kultivimin e tyre duhej të ishin shumë më të lakmuara. E dyta, pandemia që po zgjat prej një viti dhe akoma nuk i duket fundi, ka krijuar klimë angustie, pasigurie e frike. Përvoja historike botërore dëshmon se në situata të tilla njerëzit thuajse instiktivisht kërkojnë rrugëdalje dhe janë të prirur të pranojnë e të riprodhojnë narrativa me heronj e

heroina, me modele që frymëzojnë dhe ngjallin shpresë.

Jo një herë gjatë kësaj pandemie është folur për punën dhe sakrificat e mjekëve dhe infermiereve që punojnë në spitalet Covid, në tone të pergjithshme nuk kanë munguar edhe cilësimet vlerësuese, madje hera herës edhe idealizuese, por një model të personalizuar heroi nuk kemi arritur ta krijojmë.

Në vend të tij, brenda pak ditësh u bë popullore Tirja, sanitarja që u shtir si infermiere, mori një sasi të konsiderueshme paresh nga familjarët e një pacienteje dhe pastaj u tregua e pashpirt, deri në kufijtë e kafshërores, me të.

Në vend që të zbulonim, të konstruonim dhe të qarkullonim heroin, u ndeshëm sa hap e mbyll sytë me figurën e keqbërësit që, si barërat e këqija rritet e përhapet vetiu. Po t'i besosh Jungut, si nevoja për heroin edhe ajo për keqbërësin janë të fuqishme se mbesheten në dy arketipe të trashëguara dhe mjaft të hasura. Fakti që shoqëri si kjo jona priren më shumë

nga keqbërësi sesa nga heroi nuk lidhet me psikologjinë, por me kontekstin social.

Jemi vend i vogël, me hapësira të ngushta, ku gjithsecili njej gjithsecilin me libër shtëpie e me inventar katandie. Ky mund të jetë njëri nga shkaqet pse jemi të prirur të mos i pranojmë figurat publike apo, akoma më keq, t'i përbaltim e t'i zhbëjmë.

Zullumit të vendit të vogël i shtohet edhe varfëria. Nuk mjafton që hapësirën gjeografike e kemi të ngushtë, po kaq të ngushtë dhe asfik-suese e kemi pasur dhe e kemi edhe hapësirën ekonomike. Në rrethana të tilla, kur të mirat materiale e shpirtërore janë me pakicë dhe s'mjaftojnë për të gjithë, hyjnë në punë më shumë përjashtimi e sesa meritokracia, kurse përbaltja ia zë vendin inkurajimit e vlerësimit.

Sikur të mos mjaftonin gjithë këto pengesa me rrënjë në të shkuarën dhe degë e gjeth' në të sotmen, vjen e shtohet edhe një tjetër faktor pengues, tërësisht modern. Është fjala për mediat dhe modën e njerëzve të shquar,

celebrity-ve, që ato po kultivojnë.

Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë, shumica e ikonave të famshme që ofrojnë mediat vijnë nga sporti, argëtimi dhe politika. Një pjesë e mirë e këtyre janë të famshëm, jo për vlera dhe kontribute, por thjesht sepse të tillë përvijohen nga mediat.

Natyrisht moda e njerëzve, që bëhen të famshëm vetëm e vetëm se duhen njerëz të famshëm, është dukuri botërore. Po ndër ne ka një specifikë: personazhe të tillë i gjen me shumicë jo vetëm në mediat rozë, por edhe në ato më seriozet.

Si në shumë fusha të jetës akoma nuk kemi arritur të vëmë kufij mes bodrumit të shoqërisë dhe kateve të banuara, përzihen e bashkëjetojnë në mediat tona edhe njerëz, edhe minj. Popullariteti mediatic nuk para pyet për vlerat, i rëndësishëm është sensacioni, klikimet, audiencia.

3.

Kur thekson nevojën që kemi si shoqëri për heronj e modele pozitive, për t'i pikasur qoftë edhe si embrion dhe pastaj për t'i rikonstruktuar e qarkulluar përmes mediave, mund të zgjosh reagime moraliste dhe racionaliste.

Ne akoma nuk jemi çliruar nga mitet me pellazgë e stërgjyshër të lavdishëm, do qortonin këta, kurse ti kërkon mite të reja. Dhe pastaj mund të shtonin se mitet e zanafillave të lavdishme janë thjesht mburrje që krijojnë megalomani dhe ikje nga problemet e kohës, kurse mitet e reja kallaisin realitetin ekzistues dhe i shërbejnë pushtetit të radhës.

Dhe në një pikëvështrimi do të kishin të drejtë. Vetëm se duam s'duam ne mitet, si instrumenta që rikonstruktajnë modele e heronj janë dhe pas gjasash do të vazhdojnë të jenë pjesë e përditshmërisë. Mund të mbylлим sytë e të mos i shohim, por ato janë e do të vazhdojnë të jenë rreth nesh.

Me sa duket mediat, bizneset, tregu nuk bëjnë dot pa to, ndaj i krijojnë dhe i bëjnë publike pa ndërpreje. Problemi është se në një shumicë rastesh këta heronj, zakonisht politikanë, sportistë, aktorë etj., nuk kthehen në modele për virtytet që kanë dhe vlerat që promovojnë, po për rrobat që veshin, këpucët që mbathin dhe sidomos për batutat dhe sharjet që artikulojnë.

Të velur nga këta lloj heronjsh dhe të dogëndisur nga Turet njerëzit dhe sidomos të rinjtë tjetërsohen përditë e më shumë me realitetin social dhe përdorin këmbët si mjet të vetëm për t'i shpëtuar frymës depressive.

Rashid A.Khan
Solicitor
(Principal)
Tel: 07774222062



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



JENI NE BRITANI DHE KENI PROBLEME ME EMIGRACIONIN ?

Ejani ne zyren tone te diskutoni çeshtjen tuaj

190 MERTON HIGH STREET
WIMBLEDON , LONDON
SW19 1AX

One minute walk from
South Wimbledon
Underground Station

NE MUND T'JU NDIHMOJME

- *Asylum & Immigration
- *New Point Based System
- *Settlement Applications
(ILR)
- *European Law
- *Nationality&Travel
Document
- *Human Rights Applications
- *High/Court of Appeals
- *Switching Visas
- *Over Stayers
- *Legacy Cases
- *Work Premits
- *Visa Extensions
- *Judicial Reviews
- *Tribunal Appeals



KONSULTIMET JANË FALAS

T : 02085401666
MB:07878335000

EMAIL - SOLICITORS@RASHIDANDRASHID.CO.UK